



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit me karakter profesional në
“Ndhmës Dentist”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër
Moisiu”, Durrës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Alba Koshovari
2. Dr. Stela Panteqi

Qershor 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit me karakter profesional në “Ndhmës Dentist” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në “Ndhmës Dentist”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH Nr. 4500 Prot., datë 21.06.2007
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR Nr. 7239/1, datë 17.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 323, datë 22.10.2020.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit: (2022- 2023)	5 PAE/ 5 PAK
18	Numri i studentëve:	2020- 2021: 44 studentë 2020- 2021: 41 studentë 2020- 2021: 46 studentë
19	Komente / të tjera:	-




Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail : info@ascal.al

Tel : +355 (04) 22-43423

Web site : www.ascal.al

Faqe 2

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi se programi studimi me karakter profesional 2 vjeçar “Ndihmës Dentist” ofrohet nga Fakulteti i Studimeve Profesionale, Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore. Ky program është miratuar si fillim me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në datën 22.06.2007, për hapjen e degës “Ndihmës Dentist” në Universitetin e Durrësit. Programi i studimit i organizuar në 2 vite, 120 kredite.

Ky program u riorganizua më 2018 deri në masën 20% me Vendimin Nr. 88, datë 14.06.2018 bazuar legjislationit në fuqi të Arsimit të Lartë me Vendim Senati akademik të UAMD. Riorganizimi i kurrikulës, në vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, çoi në grupimin e lëndëve të kategorisë formuese si prsh. lëndë bazë, karakterizuese, ndrdisiplinore, plotësuese, detyrimet përmbyllse me kreditet dhe përqindjet përkatëse bazuar vendimit.

Aftësimi praktik zë rreth 25 % të programit.

Programi ofron njohuri me karakter profesional për ndihmës dentist, duke i përgatitur ata profesionalisht me një kualifikim të duhur për t'ju përgjigjur tregut të punës.

Pasi përfundimit të studimeve, të diplomuarit si “Ndihmës Dentist” në programin e studimit me Karakter Profesional 2 vjeçar, në Universitetin e Durrësit synohet të kenë përfituar njohuritë dhe kompetencat e duhura për të punuar si profesionistë në sektorin privat.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në dispozicion të gjithë dokumentacion e nevojshmën të paraqitur nga ASCAL për UAMD si aplikues për akreditim.

GVJ u njoh me programin e studimit profesional në ciklin 2 vjeçar të studimit Diplomë Profesionale “Ndihmës Dentist”, RVB, pedagogët hartues, lëndët dhe syllabuset.

Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës në institucion u njoh me infrastruktuën dhe materialet laboratorike të vëna në shërbim të studentëve, takoi nga afër pedagogët mjekë dhe pedagogët laborantë, u njoh me procedurat e rekrutimit të tyre, si dhe u sqaruan një sërë pyetjesh që grupi pati lidhur me kriteret dhe standardet sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Një vëmëndje e veçantë, iu kushtua edhe takimit me studentë të vitit të parë dhe të vitit të dytë të programit që është në proces akreditimi. GVJ u njoh me aktivitetet e tyre të organizuara nga institucioni.


UAMD ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh të arsimit të lartë, ndërkombëtare dhe vendase. Në zbatim të strategjisë së zhvillimit të institucionit dhe objektivave të procesit mësimor, universiteti ka shtuar përpjekjet për të krijuar lidhjet e duhura me institucione të ndryshme.

Këto bashkëpunime nëpërmjet aktiviteteve frytdhënëse, kanë dhënë rezultate në formimin e studentëve dhe përmbushjen e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve.

Më datë 20.05.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 19/83 Prot., datë 20.05.2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës kthehu përgjigje në sistemin AMS më datë 27.05.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 981/1, datë 27.05.2024.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.



Vlerësimi i programit të studimit me karakter profesional “Ndhmës Dentist” në UAMD

1. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Aleksandër Moisiu” ka rishikuar të gjitha aktet normative të ligjit për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” duke zbatuar këto akte ligjore si dhe nënligjore të tij. Programi i studimit me karakter profesional në Ndhmës Dentist ofrohet në përputhje të plotë me interesat kombëtare të vendit, Statutin e tij si dhe rregulloren e programit të studimit. Ky program i referohet Strategjisë Kombëtare për shëndetësinë 2016-2020 me VKM, Nr, 439, datë 15.05.2017. <i>Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit.</i> <i>Evidenca Nr.04 Statuti i UAMD.pdf</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit me karakter profesional në “Ndhmës Dentist” është hartuar në përputhje dhe në zbatim të misionit dhe qëllimit të UAMD. Ky program mbështetet plotësisht në statusin, rregulloren, Planin Strategjik të Institucionit, si dhe Kodin e Etikës të UAMD. Synimi i programit është të përgatisë ndihmës dentistë me kompetenca dhe aftësi profesionale, kulturore akademike në një mjedis konkurrues cilësor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit.</i> <i>Evidenca Nr.04 Statuti i UAMD.pdf</i> <i>Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	UAMD funksionon mbështetur në Strategji Ndërkombëtarizimi 2016-2020 dhe Planin Strategjik Institucional. Ky Universitet, si dhe Fakulteti i Studimeve Profesionale ka misionin e tij. Programi synon të aftësojë studentët praktikisht në asistimin në disiplina të ndryshme të dentistrisë konform fushës së aktivitetit akademik të institucionit. <i>Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit.</i> <i>Evidenca Nr.06.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2016-2020).pdf</i> <i>Evidenca Nr.03 Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë VKM nr.710, datë 1.12.2017.pdf</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Programi i studimit “Ndhmës Dentist” në UAMD i hapur më 2007. Ai është hartuar duke u bazuar studimeve të tregut si dhe nevojave në rritje të asistentëve dentare në vendin tonë. Kërkesat për këtë program janë të shumta dhe kuotat e aprovuara sipas MAS plotësohen qysh në fazat e para të aplikimit nga maturantët. <i>Takimi me Drejtuesit.</i>

	<p><u>Evidenca Nr.116 Studimi i Tregut te punes ND.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.02 Strategjia Kombëtare për Shëndetsinë VKM nr. 439, datë 17.05.2017.pdf</u></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UAMD ka arritur të afrojë në Programin e studimit "Ndhmës Dentist" personel akademik të përzgjedhur, të angazhuar me kohë të plotë dhe të pjesëshme. Ata mbulojnë plotësisht nevojat për staf duke synuar rritje të cilësisë së mësimdhënies. Ata janë të përgatitur në fushën e mjekësisë dhe me specializime të përshtatura sipas programit ku lektronin, mjekë, laborantë dentarë, me grada dhe tituj shkencorë. Eksperiencia e tyre ndër vite kontribuon ndjeshëm në përgatitjen e studentve në aspektin teoriko-praktik. Për vitin akademik 2021-2022, Stafi akademik i DSHTM përbëhet nga 68 anëtarë në total, prej të cilëve numërohen 15 staf me kohë të plotë dhe 53 me kohë të pjesëshme. 1 anëtar është me titullin akademik "Profesor Doktor", 8 anëtarë "Doktor Shkencash", 3 anëtarë Spa, 2 anëtarë Msc, 1 anëtar në proces Doktorature.</p> <p><i>Vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore</i></p> <p><u>Evidenca Nr.76 Te dhena tabelore per personelin akademik te DSHTM (ngarkesa e stafit, cilesia e stafit).pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.75 Te dhena tabelore per Personelin Akademik te DSHTM.pdf</u></p>
<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimit programi "Ndhmës Dentist" është i nivelit të 5 (pestë). Fusha e programit të studimit në "Ndhmës Dentist" është në përputhje me fushën e përgjithshme të programit të studimit e cila përfshinte arsimimin dhe kualifikimin profesional të studentëve në fushën Akademike e Kërkimore të Njësisë Kryesore të FSP. Është propozuar kodifikimi sipas direktivave dhe udhëzimeve evropiane ISED (F-2013), ku ky program bënte pjesë në fushën e përgjithshme (09) numër 8 sipas tabelës së kodifikimit. <i>Takim me Drejtuesit, sekretarinë.</i></p> <p><u>Evidenca Nr.06.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2016-2020).pdf</u></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>UAMD ushtron veprimtarinë dhe aktivitetin e tij në përputhje me legjislacionin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe në përputhje me të ka rishikuar të gjitha aktet normative. Programi i studimit me karakter profesional në "Ndhmës Dentist" është hartuar në përputhje dhe në zbatim të misionit dhe qëllimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu". Programi është hapur prej vitit 2007, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në formimin me njohuritë bashkëkohore në profesionin e ndihmës dentisti ndër vitet. Programi i studimit me karakter profesional në Ndhmës Dentist ofrohet në përputhje të plotë me interesat kombëtare të vendit, Statutin si dhe rregulloren e programit të studimit. Programi synon të aftësonjë studentët praktikisht në asistimin në disiplina të ndryshme të dentistrisë konform fushës së aktivitetit akademik të institucionit. Në këtë program janë angazhuar staf i mjaftueshëm dhe i përgatitur për mësimdhënie si nga ana teorike por edhe praktike.</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UAMD funksionon si një Institucion i mirëorganizuar me struktura akademike, administrative, ndihmës akademike dhe mbështetëse në nivel Fakulteti dhe Rektorati. Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike bashkëpunon me Departamentin për publikimet, aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, bazën e të dhënave mbi punësimin dhe Alumnin. Të tjera struktura funksionale bashkëpunojnë në lidhje me rishikimin e kurrikulave, cilësinë e mësimdhënies, shpërndarjen e ngarkesave mësimore sipas kërkesave, kërkimin shkencor, menaxhimin financiar, arshivimin e dokumentacionit. Të gjitha njësitë dhe strukturat bashkëpunojnë ngushtësisht me njëra tjetrën dhe janë të afishuara në Organigramën e Institucionit. Dokumentacioni ligjor, Raportet vjetore etj. depozitohen dhe ruhen të arshivuara sipas rregjistrimit të protokollit. Dokumentacioni studentor dhe pedagogjik është plotësuar dhe ka mundësi aksesimi.</p> <p><i>Vizita në institucion. Takimi me studentët.</i></p> <p><u>Evidenca Nr.10 Rregullore e programi te studimit Ndhimes Dentist.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.18 Rregullore Drejtori e admin. e sherbime akademike.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UAMD bazuar Planit Strategjik FSP, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë (Projekti Erasmus në Lion) dhe vendas për projekte, konferenca, aktivitete krkimore-shkencore të përbashkëta të BE, Erasmus +. Në zbatim të strategjisë së zhvillimit të institucionit dhe objektivave të procesit mësimor, universiteti ka shtuar përpjekjet për të krijuar lidhjet e duhura me institucione të ndryshme, organizata të huaja dhe kompani prodhuese, për zhvillimin e praktikave mësimore, për mobilitet për studentët dhe pedagogët.</p> <p><i>Vizita në institucion. Takimi me stafin dhe studentët.</i></p> <p><u>Evidenca Nr.34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.38.1 Projekt Erazmus per studentet.pdf</u><u>Evidenca Nr.135 Ceppus Agreement intership.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave</p>	<p>UAMD numëron 20 marrëveshje bashkëpunimi afatgjata me institucione vendase, kryesisht për kryerjen e praktikave profesionale apo dhe aktivitete të tjera më studentët Ndhimës dentar. Mund të përmendim një numër të konsiderueshëm Klinikash Dentare private, Universitete vendase dhe të huaja, Spitale, Shoqata, FSDKSH Durrës, QKUM, QVEC etj.</p> <p>Një ndihmesë të madhe në këtë drejtim ka dhënë Drejtoria e Projekteve</p>

<p>profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>dhe Marrëdhënieve me Jashtë e cila ka mundësuar këto marrëveshje bashkëpunimi të cilat janë zbatuar. <i>Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit.</i> <u><i>Evidenca Nr.94 Marreveshtjet e Bashkepunimit te DSHTM.pdf</i></u> <u><i>Evidenca Nr.95 Korrespondenca me Spitalin Rajonal Durrës.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore është përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit. Koordinatori i Programit Ndihmës Dentist realizon raportet analitike të ecurisë së praktikave profesionale në muajin Korrik pikërisht në përfundim të praktikave. Pandemia e Covid 19 si dhe Tërmeti që preku Durrësin në nëntor 2019 ndikuan në mbarëvajtjen e praktikave të cilat u realizuan duke rihartuar dhe riplanifikuar shpërndarjen e praktikave (Numri i studentëve nëpër klinika duhet të është i limituar për shkak të pandemisë). Ndërsa në analizën vjetore që zhvillon institucioni, është hartuar raporti i realizimit të programit në të cilin jepet edhe vlerësimi i arritjeve nga marrëveshjet e nënshkuara, evidentimit të rasteve pozitive dhe përfitimit maksimal nga bashkëpunime të frytshme. Njëkohësisht vlerësohet edhe nevoja për gjetjen e bashkëpunëtorëve e partnerëve të rinj në fusha specifike të veprimtarisë së institucionit dhe që i shërbenin personelit akademik dhe studentëve. <i>Takimi me stafin, studentët</i> <u><i>Evidenca Nr.94 Marreveshtjet e Bashkepunimit te DSHTM.pdf</i></u> <u><i>Evidenca Nr.39 Shoqata Alumni UAMD.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Marrëveshjet me klinikat dentare në Shqipëri, ku studentët kryejnë praktika profesionale ndihmojnë për punësim të studentëve pas diplomimit. Në faqen e Universitetit publikohen njoftimet për punësim në mënyrë që studentët të kenë dijeni dhe të kontaktojnë edhe drejtpdrejtë me punëdhënësit. Kërkesat për punësim nga klinika dentare janë të shumta. Ato i përcillen menjëherë studentëve të cilët mbeten të interesuar. Kontaktet e studentëve ruhen, në data bazën e shkollës dhe mbrohen duke i shfrytëzuar pozitivisht nga Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierrës për informimin e vazhdueshëm për vendet e lira të punës ofruar për ta. <i>Takimi me studentët.</i> <u><i>Evidenca Nr.39 Shoqata Alumni UAMD.pdf</i></u> <u><i>Evidenca Nr.94 Marreveshtjet e Bashkepunimit te DSHTM.pdf</i></u> <u><i>Evidenca Nr.12 Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf</i></u></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD funksionon si një Institucion i mirëorganizuar me struktura akademike, administrative, ndihmës akademike dhe mbështetëse në nivel Fakulteti dhe Rektorati. Në zbatim të Strategjisë së zhvillimit të institucionit dhe objektivave të procesit mësimor, universiteti ka shtuar përpjekjet për të krijuar lidhjet e duhura me institucione të ndryshme, organizata të huaja dhe kompani prodhuese, për zhvillimin e praktikave mësimore, për mobilitet për studentët dhe pedagogët. Marrëveshjet me klinikat dentare në Shqipëri, ku studentët kryejnë praktika profesionale ndihmojnë për punësim të studentëve pas diplomimit.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sipas nenit 103 të Ligjit të Arsimit të Lartë, UAMD ka ngritur dhe ka vënë në funksion Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë NjSBSC e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohet në Rreguloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>NjSBSC harton procedura dhe politika për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe kërkesave arsimore.</p> <p>Në planin afatshkurtër të zhvillimit, synimi kryesor është garantimi i cilësisë së mësimdhënies në përputhje me Standardet shtetërore dhe Kodin e cilësisë. UAMD çdo vit vlerëson performancën e personelit akademik dhe ndihmës akademik në lidhje me zbatimin cilësor të programit të studimit jo vetëm në aspektin e mësimdhënies, por edhe në atë të kërkimit shkencor, kualifikimit dhe kontributit intelektual në institucion.</p> <p><i>Takimi me, NJSBC, studentët.</i></p> <p><u><i>Evidenca Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca Nr.27 Të dhëna tabelore për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në S.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në UAMD funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, NjSBSC, duke patur fokus Strategjinë e Zhvillimit të UAMD. NjSBSC bazohet në disa elemente thelbësore të funksionimit si, Mbështetja dhe ekspertiza, Bashkërendimi, Interpretimi, Monitorimi. Propozimet për zgjidhjen e problematikave të evidentuara nga NjSBSC, shqyrtohen në varësi të nivelit të çështjes Rektorit dhe Senatit Akademik ose KPGSC-së. Çdo Departament ka NjSBSC e vet.</p> <p><i>Takimi me, NjSBSC</i></p> <p><u><i>Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca Nr.04 Statuti i UAMD.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca Nr.24 Raporti i sigurimit te cilesise UAMD.pdf</i></u></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>NjsBC përdor instrumentin e analizimit të arritjeve të misionit institucional të një grupi treguesish kyç të performancës (TKP-si ruajtja e nivelit të regjistrimeve, kalushmërisë, diplomimit, ndërkombëtarizimi, diversiteti i profileve studentore, etj.) për arritjen e objektivave strategjike institucionale duke e rifreskuar ate në mënyrë të vazhdueshme. Realizohen Raportet periodike dhe vjetore, vlerësimet nga ASCAL, Vetëvlerësimet, akreditimet institucionale e kryera më 2016 dhe 2022, etj.</p> <p><i>Takimi me, NJSBC, studentët.</i></p> <p><u>Evidenca Nr.25 Raporti i Veprimtarise Audituese V.A. 2013-2018.pdf</u> <u>Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf</u> <u>Evidenca Nr.70 Analiza vjetore e FSP 2020- 2021.pdf</u></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>NjsBC gjeneron analiza të shoqëruara me të dhëna, të cilat shërbenin për evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta që ka institucioni. Sigurimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm dhe reflektohet në raportet periodike 3-6-12 mujore.</p> <p>NjsBC në bazë të raporteve/analizave jep rekomandimet e saj për nxitjen e praktikave të mira dhe përmirësimin e pikave të dobëta. NjsBC analizon dhe krahason rezultatet bazuar treguesve të clësisë të Kodit të Cilësisë dhe akteve ligjore dhe nënligjore.</p> <p>UAMD përdor tregues të matshëm për vlerësimin e mësimdhënies, mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe mangësive. <i>Takimi me NJSBC.</i></p> <p><u>Evidenca Nr.17 Rregullore e Keshillit te kerkimit shkencor.pdf</u> <u>Evidenca Nr.16 Rregullore baza e te dhenave te kerkim shkencor.pdf</u></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>NjsBSC harton procedura dhe politika për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe kërkesave arsimore. NJSBC bazohet në disa elemente thelbësore të funksionimit si, Mbështetja dhe ekspertiza, Bashkërendimi, Interpretimi, Monitorimi. NjsBC në bazë të raporteve/analizave jep rekomandimet e saj për nxitjen e praktikave të mira dhe përmirësimin e pikave të dobëta. NjsBC analizon dhe krahason rezultatet bazuar treguesve të clësisë të Kodit të Cilësisë dhe akteve ligjore dhe nënligjore.</i></p> <p><i>UAMD përdor tregues të matshëm për vlerësimin e mësimdhënies, mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe mangësive.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				

<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi Studimit me Karakter Profesional 2 vjeçar Diplomë Profesionale “Ndhmës Dentist” përmbush detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë, është në harmoni të plotë me misionin e UAMD dhe reflekton të gjitha kërkesat e parashtruara në VKM Nr. 41. datë 24.01.2018 . Modulet dhe lëndët janë të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në një vit akademik studenti grumbullon 60 kredite, në total 120 kredite për 2 vite akademike. Ngarkesa mësimore ndahet në orë mësimore në auditor dhe jashtë auditori, në forma të ndryshme mësimdhënie si : leksionet interaktive, seminare, laboratore, detyra kursi, dhe punë e pavarur e studentëve jashtë auditorit për përgatitje diplome. <i>Dokumentacioni i ofruar Programi i studimit Takimi me stafin</i> Evidenca Nr.06.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2016-2020).pdf Evidenca Nr.121 Dosja e programit te studimit (kurikula , plani mesimor, dhe personeli akademik).pdf Evidenca Nr.77 Te dhena tabelore per programet e studimit te DSHTM (programet, bashkepunimet,ngarkeasa .pdf Evidenca Nr.99 Orari mesimor i tre viteve te fundit.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>Programi Studimit me Karakter Profesional 2 vjeçar Diplomë Profesionale “Ndhmës Dentist” synon aftësimin teoriko-praktike të studentëve në fushën e asistencës dentare bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit. Njohuritë që studentët marrin përfshijnë pothuajse të gjitha fushat e dentistrisë. Nëpërmjet programit dhe përmbajtjes së moduleve, metodave të mësimdhënies, projekteve dhe detyrave të ndryshme, praktikave dhe punimit përfundimtar, synohet që tu japë studentëve njohuri të përparuara akademike dhe shprehje praktike në fushën e dentistrisë dhe teknikave dentare, si dhe të zhvillohet i kuptuari kritik i koncepteve që jepeshin në teori nëpërmjet aplikimit praktik të tyre në klinikat dentare ku janë nënshkruar marrëveshje me UAMD. Shpërndarja e orëve është në favor të praktikës duke garantuar përgatitjen cilësore të studentëve me aftësi praktike, menaxheriale dhe komunikuese. <i>Takimi me stafin, studentët.</i> Evidenca Nr.99 Orari mesimor i tre viteve te fundit.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet,</p>	<p>UAMD në misionin e tij sipas Programit të studimit si “Ndhmës Dentist” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe praktike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Objektivat janë të</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail : info@ascal.al


Tel : +355 (04) 22-43423

Web site : www.ascal.al

Faqe 11




<p>aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>arritshme nga studentët të cilët përkushtohen duke punuar në grupe për të përballuar situata kritike dhe emergjente. Ato janë të përcaktuara qartë në cdo syllabus në lëndët përkatëse.</p> <p><i>Takim me stafin, sekretarinë</i></p> <p>Evidenca Nr.123 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2019-2020.pdf Evidenca Nr.124 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2020-2021.pdf Evidenca Nr.125 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2021-2022.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi “Ndhimës Dentist” 2 vjeçar përmban të gjithë elementet që përbëjnë strukturën e një programi studimi bashkëkohor. Programi i studimit është organizuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai ka 120 ECTS në total. Praktika Profesionale I ka 7 kredite, dhe Praktika Profesionale II ka 7 kredite si dhe detyrimet përmbyllëse me 5 kredite. 1 kredit vlerësohet me 25 orë mësimore. Studenti diplomohet vetëm kur ka shlyer të gjitha detyrimet akademike.</p> <p><i>Takimi me stafin</i></p> <p>Evidenca Nr.121 Dosja e programit te studimit (kurikula , plani mesimor, dhe personeli akademik).pdf</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UAMD ka hartuar programin e studimit duke iu referuar legjisllacionit përkatës vendas dhe europian. Programi ofrohet me kohë të plotë dhe në gjuhën shqipe. Pranimi i studentëve bëhet në bazë të rregullores së këtij programi studimi si dhe ligjit për arsimin e lartë. Institucioni zhvillon edhe politika të marketingut të programit të studimit duke nxitur aplikimet në këtë program.</p> <p><i>Takimi me Drejtuesit</i></p> <p>Evidenca Nr.103 Politika te marketingut te programit te studimit, Trasparenca me Publikun.pdf Evidenca Nr.72 Java e orientimit te studenteve.pdf Evidenca Nr.68 Te dhena nga plani i financimit te programit te studimit (kostot e programit Ndhimes Den.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>UAMD ofron Programin e Studimit me Karakter Profesional 2 vjeçar Diplomë Profesionale “Ndhimës Dentist” si pak programe të këtij lloji në IAL në Shqipëri. Për hartimin e programit që në 2007 kur u hap për herët ë parë u morrën për bazë shembuj të programeve që ofrohen nga institucionet e tjera botërore më të mira të kësaj fushe.</p> <p><i>Takimi me Drejtuesit</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>UAMD ka kryer kodifikimin e programit sipas Udhëzimit të MASR. Ky program studimi renditet në nivelin e 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tij si dhe emërtesa është në përputhje me fushën akademike të FSP.</p> <p><i>Takimi me stafin</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit përmbush detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin e Arsimit te Lartë, është në harmoni të plotë me misionin e UAMD. Nëpërmjet programit dhe përmbajtjes së moduleve, metodave të mësimdhënies, projekteve dhe detyrave të ndryshme, praktikave dhe</i></p>




	punimit përfundimtar, synohet që tu jepeshin studentëve njohuri të përparuara akademike dhe shprehi praktike në fushën e dentistrisë dhe teknikave dentare, si dhe të zhvillohet i kuptuari kritik i koncepteve që jepeshin në teori nëpërmjet aplikimit praktik të tyre në klinikat dentare ku janë nshkruar marrëveshje me UAMD. UAMD ka hartuar programin e studimit duke iu referuar legjislacionit përkatës vendas dhe europian.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Studimeve Profesionale (FSP) është njësia kryesore për Programin e Studimit me Karakter Profesional 2 vjeçar Diplomë Profesionale "Ndhmës Dentist". Ndërsa njësia përgjegjëse për këtë program studimi është DSHTM si një nga 3 departamentet e FSP. Kjo njësi përbëhet nga 16 anëtarë dhe përmbush plotësisht të gjitha detyrimet ligjore të organizimit dhe infrastrukturës akademike në funksion të arsimit cilësor. Për vitin akademik 2021-2022 evidentohen <u>16 anëtarë PAE</u> , 10 Dr., 1 Dr. Proces, 5 Msc, <u>49 anëtarë PAK</u> , 1 Prof. Dr, 11 Dr., 1 Dr. Proces, 36 Msc, <u>2 personel PNA</u> , numri total 57. (Tabelat dega 2 vjeçare Ndhmës Dentist) Programi akreditohet për herë të parë. <i>Takim me Drejtuesit, sekretarinë</i> <i>Evidenca Nr.76 Te dhena tabelore per personelin akademik te DSHTM (ngarkesa e stafit, cilesia e stafit, pdf</i> <i>Evidenca Nr.69 Te dhena te plota per Infrastrukturen e FSP dhe ne funksion te programit te studimit 2022.pd</i> <i>Evidenca Nr.118 Urdhri per Hapjen e Programit te Studimit ND.pdf</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Në strategjinë e institucionit , krahas zhvillimit të personelit akademik, institucioni i kushton një rëndësi të veçantë zhvillimit edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Personeli ndihmës-akademik i angazhuar në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e orëve mësimore të programit dy vjeçar Ndhmës Dentist, është i trajnuar dhe kualifikuar. Bazuar në planin mësimor të çdo viti akademik, fakulteti përveç personelit akademik të brendshëm angazhon edhe personel akademik me kohë të pjesshme, duke ruajtur raportin 70% me 30%. Kështu mund të evidentohen për 3 vitet e fundit (Evidenca 130): <u>Për vitin akademik 2019-2020</u> Lektorë me gradën Dr/Phd 5 PAE 2 PAK raporti 71%/28% Asistentë Msc 2 PAE 2 PAK raporti 50%/50% <u>Për vitin akademik 2020-2021</u>

	<p>Lektorë me gradën Dr/Phd 5 PAE 2 PAK raporti 71%/28%</p> <p>Asistentë Msc 2 PAE 2 PAK raporti 50%/50%</p> <p><u>Për vitin akademik 2021-2022</u></p> <p>Prof.As. 1 PAE 0 PAK raporti 100%/0%</p> <p>Lektorë me gradën Dr/Phd 4 PAE 2 PAK raporti 66%/34%</p> <p>Asistentë Msc (Dr.proc.) 1 PAE 0 PAK raporti 100%/0%</p> <p>Asistentë Msc 1 PAE 6 PAK raporti 14%/86%</p> <p>Në UAMD ka 8 laboratorë funksionalë për FSP 4 prej të cilave i përkasnin DSHTM. Studentët aftësohen në këto laboratore por ata kanë edhe mundësi të tjera për tu praktikuar në klinika dentare, spitalin rajonal Durrës, etj. Ata mbikqyren nga staf i specializuar laborantë dentarë, të drejtuar nga një koordinator dhe punojnë në grupe të vogla me nga 5 studentë ku ndihmohen vazhdimisht nga mjekët stomatologë me të cilët bashkëpunojnë ngushtësisht.</p> <p><i>Takim me Drejtuesit, sekretarinë</i></p> <p><u>Evidenca Nr.130 Te dhena tabelore per personelin akademik ne programin e studimit Ndhimes dentist.pdf</u></p>								
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Për çdo program studimi, Fakulteti cakton çdo vit një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit, praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori në takimet e planifikuara në Departament raporton në lidhje me ecurinë e procesit mësimor, aspektet pozitive, problemet si dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre. Takime të tjera realizohen sipas rastit dhe problematikave të dala.</p> <p><i>Takimi me Stafin</i></p> <p><u>Evidenca Nr.126 Raportet e kordinatorit te programit te studimit mbi ecurine e programit te studimit, m.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.127 Udhezimi koordinatorit per vleresimin e provimit final.pdf</u></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Studimeve Profesionale (FSP) është njësia kryesore për Programin e Studimit me Karakter Profesional 2 vjeçar Diplomë Profesionale "Ndhimës Dentist". Ndërsa njësia përgjegjëse për këtë program studimi është DSHTM. Personeli ndihmës-akademik i angazhuar në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e orëve mësimore të programit dy vjeçar Ndhimës Dentist, është i trajnuar dhe kualifikuar. Bazuar në planin mësimor të çdo viti akademik, fakulteti përveç personelit akademik të brendshëm angazhon edhe personel akademik me kohë të pjesshme, duke ruajtur raportin 70% me 30%. Për çdo program studimi, Fakulteti cakton çdo vit një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit, praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Njësia Bazë përgjegjëse për Programin e Studimit me Karakter Profesional 2 vjeçar Diplomë Profesionale "Ndihmës Dentist", disponon dosjen e plotë të programit të studimit si dhe është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së programit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të saj. Mësimi është oraganizuar në 2 semestra për secilin vit akademik, kreditet, orët në auditor, jashtë auditorit, totalin e orëve. Planet mësimore përfshinin informacione të nevojshme me karakter informativ dhe praktik Përveç orëve teorike janë parashikuar orët laboratorike dhe praktike 350 orë gjithsej. Secili vit ka 7 kredite të përcaktuara për Praktikën 1 dhe 2 si dhe 5 kredite për për detyrimin përmbyllës të studentëve. Studentët njihen me organizimin e mësimin dhe shpërndarjen e praktikave nga personeli akademik përgjegjës. Dokumentacioni ruhet i protokolluar dhe është i aksesueshëm në çdo moment. <i>Takimi me NjSBC, stafin</i> <u>Evidenca Nr.121 Dosja e programit te studimit (kurikula , plani mesimor, dhe personeli akademik).pdf</u> <u>Evidenca Nr.77 Te dhena tabelore per programet e studimit te DSHTM (programet, bashkepunimet,ngarkeasa .pdf</u> <u>Evidenca Nr.130 Te dhena tabelore per personelin akademik ne programin e studimit Ndihmes dentist.pdf</u> <u>Evidenca Nr.129 Te dhena te plota te programit per rregjistrimin, ecurine, diplomimin, nota mesatare ne.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Njësia bazë harton planin mësimor i cili miratohet nga Dekanati i FSP dhe Senati i UAMD. Përmbajtja e programit mësimor reflektohet në planin mësimor i cili paraqiste një informacion të detajuar mbi numrin e lëndëve, moduleve, numrin e krediteve, orët në auditor dhe jashtë auditorit, tipet e veprimtarive të parashikuara dhe ngarkesën respektive të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. <i>Dokumenti i ofruar Plani mësimor. Takimi me stafin, sekretatine.</i> <u>Evidenca Nr.77 Te dhena tabelore per programet e studimit te DSHTM (programet, bashkepunimet,ngarkeasa .pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informacionet e detajuara për studentët dhe detyrimet që ata kanë reflektohen në programin e studimit. Politikat e Pranimit janë të reflektuara në nenin 22 të Rregullores së Programit ku studentët gjejnë modalitetet e pranimit dhe regjistrimit. Kuotat e lira për regjistrimet e reja në raport me personelin akademik me kohë të plotë për studentë sipas normativës së caktuar, i paraqiten MAS në avancë dhe miratohen sipas përcaktimeve të Ministrisë për çdo vit akademik. Gjithashtu ofrohen mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi në UAMD apo IAL të tjera. <i>Takimi me stafin, sekretarinë.</i> <u>Evidenca Nr.110 Kriteret e pranimit te studenteve dhe kuotat.pdf</u></p>




	<p><i>Evidenca Nr.90 Urdher per ngritjen e komisionit te transferimit.pdf</i> <i>Evidenca Nr.91 Memo mbi njohjen e krediteve te studimeve te meparshme.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit “Ndhmës Dentist” përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, ku përfshihen të gjitha Syllabuset e Lëndëve të prezantuara sipas kërkesave të VKM 41, dt.24.01.2018 në të cilat paraqiten për secilën lëndë, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Ato janë të firmosura nga Lektorët e Lëndës dhe përgjegjësi i Njesisë bazë dhe ruhen çdo vit në dosjet përkatëse në Zyrën e Kurikulave dhe të Cilësisë të UAMD.</p> <p><i>Takimi me stafin, Zyra e Kurikulave.</i></p> <p><i>Evidenca Nr.77 Te dhena tabelore per programet e studimit te DSHTM (programet, bashkepunimet,ngarkesa .pdf</i> <i>Evidenca Nr.123 Syllabuset Ndhmes dentist v.a. 2019-2020.pdf</i> <i>Evidenca Nr.124 Syllabuset Ndhmes dentist v.a. 2020-2021.pdf</i> <i>Evidenca Nr.125 Syllabuset Ndhmes dentist v.a. 2021-2022.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>UAMD para fillimit të çdo viti akademik kujdeset që për programet e studimit që ofron, të rishikohen, rifreskohen me të reja shkencore të fundit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Programi i studimit “Ndhmës Dentist” është rishikuar gjithashtu në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm deri në masën 20% të kuadrit ligjor, në përputhje me nevojat e diktuar nga studimi i tregut të punës bazuar në zhvillimin ekonomik, demografik dhe teknologjik të vendit. Ndryshimet e bëra miratohen në fillim të çdo viti akademik dhe ruhen në dosjen përkatëse të programit të studimit dhe arkivohen në Njësinë bazë.</p> <p><i>Takimi me stafin, Drejtuesit</i></p> <p><i>Evidenca Nr.15 Rregullore e Zyrës së Monitorimit të Kurrikulës.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia bazë harton planin mësimor i cili miratohet nga Dekanati i FSP dhe Senati i UAMD. Përmbajtja e programit mësimor reflektohet në planin mësimor i cili paraqiste një informacion të detajuar mbi numrin e lëndëve, moduleve, numrin e krediteve, orët në auditor dhe jashtë auditorit, tipet e veprimtarive të parashikuara dhe ngarkesën respektive të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programi i studimit “Ndhmës Dentist” është rishikuar gjithashtu në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm deri në masën 20% të kuadrit ligjor, në përputhje me nevojat e diktuar nga studimi i tregut të punës bazuar në zhvillimin ekonomik, demografik dhe teknologjik të vendit. Ndryshimet e bëra miratohen në fillim të çdo viti akademik dhe ruhen në dosjen përkatëse të programit të studimit dhe arkivohen në Njësinë bazë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>Në Programin e studimit me karakter Profesional 2 vjeçar “Ndhimës Dentist” veprimtaritë formuese janë hartuar të mundësonin thellimin e njohurive dhe aftësive praktike për studime post- diplomë si dhe për punësimin e studentëve. Emërtimi është në përputhje me fushën dhe nivelin e studimit. Ndërthurja teori -praktikë lehtëson procesin e të mësuarit dhe reflektohet më pas në rezultatet e studentëve formale, të ndërmjetme dhe ato përfundimtare. Lëndët profesionale kanë praktika lëndore duke ruajtur raportin 50% me 50% të teorisë dhe praktikës. Praktikrat në klinika dentare i ndihmojnë shumë studentët të përshtaten më lehtë në tregun e punës. <i>Dokumenti i ofruar, Programi Studimit, Plani mësimor, syllabuset. Takimi me stafin</i> Evidenca Nr.123 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2019-2020.pdf Evidenca Nr.124 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2020-2021.pdf Evidenca Nr.125 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2021-2022.pdf Evidenca Nr.77 Te dhena tabelore per programet e studimit te DSHTM (programet, bashkepunimet,ngarkeasa .pdf</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Shpërndarja e Lëndëve, moduleve, krediteve janë hartuar referuar udhëzimeve dhe rregullave, të vendosura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe akteve nënligjore në fuqi. Ato janë organizuar në mënyrë që studenti të ka një ngarkesë të balancuar semestrale dhe vjetore përgjatë 2 viteve të studimit. Në program është përcaktuar ndarja në kredite ku një semestër ka 30 kredite dhe përgjatë 2 viteve studenti ka përfituar 120 kredite. 1 kredit konvertohet me 25 orë. Raportet e veprimtarive formuese janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të garantojnë kohën e nevojshme për studentët për të marrë njohuritë e nevojshme dhe aplikimin e tyre në praktikë duke mundësuar arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si ndihmës dentist. <i>Takimi me stafin</i> Evidenca Nr.77 Te dhena tabelore per programet e studimit te DSHTM (programet, bashkepunimet,ngarkeasa .pdf</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisimit në praktikë/ punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me</p>	<p>Për faktin se Programi i studimit “Ndhimës Dentist” ka karakter profesional është ruajtur një raport i drejtë midis teorisë dhe praktikës në masën (50:50). Raporti teori/ praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Praktikrat profesionale 1 dhe 2 kanë 7 kredite me nga 175 orë të konvertuara dhe afërsisht 28% e orëve totale në auditor i përkushtohet praktikave të cilat zhvillohen në laborarë, praktika lëndore apo profesionale. <i>Takimi me stafin</i></p>

<p>programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p><i>Evidenca Nr.77 Te dhena tabelore per programet e studimit te DSHTM (programet, bashkepunimet,ngarkeasa .pdf</i> <i>Evidenca Nr.128 Shembull i Vlerësimit të një Praktike.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit “Ndhmës Dentist” ka një raport teori-praktikë në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Kjo lejon transferimin e studimeve në degë të tjera të njëta ose të ngjashme brenda dhe jashtë IAL. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundëson arritjen e objektivave formues duke ofruar njohuri, aftësim dhe kompetenca në çdo procedurë dentare klinike. <i>Dokumenti i ofruar, Programi Studimit. Takimi me stafin</i> <i>Evidenca Nr.77 Te dhena tabelore per programet e studimit te DSHTM (programet, bashkepunimet,ngarkeasa .pdf</i> <i>Evidenca Nr.121 Dosja e programit te studimit (kurikula , plani mesimor, dhe personeli akademik).pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>UAMD kryen çdo vit, bazuar në planet vjetore, procedurën për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Njësia bazë vlerëson periodikisht gjendjen e programeve të studimit, syllabuset dhe çdo element tjetër i cili ka nevojë për përmirësim dhe ndryshim. Lektorët përdorin literaturë bazë dhe ndihmëse. Ata përdorin leksione të hartuara dhe të përgatitura prej tyre, materiale bashkëkohore të përkthyer në gjuhën shqipe. Lektorët dhe studentët kanë akses në bibliotekë ku aksesojnë literaturën e përshtatshme dhe të kërkuar. Sistemi online lehtëson punën e tyre për studim dhe kërkim shkencor. <i>Takimi me stafin. Vizita ne biblioteke</i> <i>Evidenca Nr.15 Rregullore e Zyrës së Monitorimit të Kurrikulës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>UAMD nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me shumë institucione kryesisht me klinika dentare, ka krijuar lidhje të qëndrueshme të cilat i shërbenin studentëve në aftësimin e tyre profesional dhe orientimit të tyre me tregun e punës. Mqs numri i studentëve është i vogël në këtë program studimi ata punojnë në grupe të vogla dhe kjo është një përparësi për studentët, lektorët dhe institucionet pritëse duke garantuar formimin e studentëve në përputhje me kërkesat e institucionit. Sistemi i tutorazhit funksionon rregullisht. Praktika profesionale ndiqej nga lektori i lëndës në bashkëpunim me koordinatoren në vendin e praktikës. <i>Takimi me Zyrën e këshillimit të karrierës</i> <i>Evidenca Nr.12 Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar në 2 vite në përputhje të plotë me nivelin 5 të KSHK.. Ai ka si qëllim arsimimin profesional dhe kualifikimimin shkencor të studentëve në fushën e ndihmës dhe kujdesit dentar. Këto njohuri që përfshijnë të gjitha fushat e dentistrisë mundësojnë punësimin e shpejtë të studentëve në klinika brenda dhe jashtë vendit. Studentët përdorin manualet e praktikave profesionale me mbi 100 procedura praktike të cilat i aplikojnë në mbikqyrur nga profesionistët. <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>




	<i>Evidenca Nr.84 Udhezues nga zyra Karrieres - aplikim pune.pdf</i>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit është me karakter profesional. Emërtimi është në përputhje me fushën dhe nivelin e studimit. UAMD nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me shumë institucione kryesisht me klinika dentare, ka krijuar lidhje të qëndrueshme të cilat i shërbenin studentëve në aftësimin e tyre profesional dhe orientimit të tyre me tregun e punës. Programi i studimit është organizuar në 2 vite në përputhje të plotë me nivelin 5 të KSHK.. Ai ka si qëllim arsimimin profesional dhe kualifikimimin shkencor të studentëve në fushën e ndihmës dhe kujdesit dentar. Studentët përdorin manualet e praktikave profesionale me mbi 100 procedura praktike të cilat i aplikojnë në mbikqyrur nga profesionistët.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Njësitë bazë të UAMD marrin në konsideratë propozimet e të gjithë aktorëve bashkëpunues, institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë, të cilët jepnin sygjerimet e tyre duke dhënë mendime mbi përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, laboratoreve dhe praktikave profesionale. Çdo propozim për ndryshim duhet të marrë miratimin përkatës sipas shkallës së hierarkisë.</p> <p>Programi është në përputhje të plotë me kërkesat e tregut për ndihmës dentar.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p> <p><i>Evidenca Nr.95 Korrespondenca me Spitalin Rajonal Durrës.pdf</i></p>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	<p>Studentët e Programit të studimit “Ndihmës Dentist” në takimet e ndryshme nxiten dhe janë të përfshirë vazhdimisht në diskutime në lidhje me programin e studimit. Çdo propozim i bërë prej tyre merret në konsideratë dhe vlerësohet në veçanti. Studentët me përfaqësuesit e tyre në Senatën Akademik kanë mundësinë e marrjes pjesë në miratim dhe vendim marrje. Qeveria Studentore ka përfaqësuesit e saj të cilët me të drejtën e tyre legjitime shprehin mendimet për ndryshime pozitive në program por jo vetëm.</p> <p><i>Takimi me Zyrën e këshillimit të karrierës, stafin, studentët</i></p> <p><i>Evidenca Nr.84 Udhezues nga zyra Karrieres - aplikim pune.pdf</i></p>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat	<p>DSHTM si njësi përgjegjëse realizon përditësimin në mënyrë të vazhdueshme për përmirësim, përshtatje të programit të studimit</p>




<p>programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private.</p>	<p>"Ndihmës Dentar" në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme. Bashkëpunimi dhe kontaktet me IAL e tjera, Institucione si QSUT, QKUM, Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë, Klinika dentare, kanë ndihmuar së tepërmi në përmirësimin e programit por edhe me ndryshimet e tregut të punës.</p> <p><i>Takimi me stafin</i> <i>Evidenca Nr.34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD.pdf</i> <i>Evidenca Nr.94 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të DSHTM.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh me të cilët janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, kontrata dhe angazhime. Studentët e Programit të studimit "Ndihmës Dentist" në takimet e ndryshme nxiten dhe janë të përfshirë vazhdimisht në diskutime në lidhje me programin e studimit. Çdo propozim i bërë prej tyre merret në konsideratë dhe vlerësohet në veçanti. DSHTM si njësi përgjegjëse realizon përditësimin në mënyrë të vazhdueshme për përmirësim, përshtatje të programit të studimit "Ndihmës Dentar" në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar VKM. 41 datë 24.1.2018 të MAS, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" si dhe Rregullores së FSP neni 42, format e mësimdhënies janë: leksionet, seminarët, detyrat/projektet individuale, punët laboratorike dhe praktikat mësimore e profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni, të cilat realizohen në përputhje me planin mësimor në auditor, jashtë auditori dhe në institucione dentare. Raportet e orëve janë shpërndarë bazuar legjislacionit në fuqi. <i>Takimi me stafin, Zyrën e kurrikulave</i> Evidenca Nr.134 VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, ka eksperiencë të konsiderueshme në mësimdhënie si dhe aftësi profesionale të organizojnë veprimtaritë e tyre të procesit mësimor, në funksion të përmbushjes së nevojave të studentëve. Metodologjia e mësimdhënies është përshtatur me natyrën e programit të studimit duke mundësuar forma të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve të formateve të ndryshme. Studentët shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që Universiteti i ofron, si në infrastrukturë, bazë materiale, komunikim dhe bashkëpunim me klinika dentare, për të zhvilluar praktikat mësimore. <i>Takimi me stafi, studentët</i> Evidenca Nr.123 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2019-2020.pdf Evidenca Nr.124 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2020-2021.pdf Evidenca Nr.125 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2021-2022.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Infrastruktura në dispozicion të personelit akademik lejon dhe mundëson përdorimin e teknologjisë informatike dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies për të arritur rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve. Institucioni organizon në mënyrë të planifikuar trajnime për stafin nëpërmjet QEV. Si rezultat përfitimi shkon në favor të studentëve pasi të gjitha njohuritë e marra në këto aktivitete ju transmetohen studentëve. <i>Takimi me stafin</i> Evidenca Nr.74 Konferencat dhe aktiviteti shkencor i stafit akademik DSHTM.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në</p>	<p>Personeli akademik plotëson kriteret ligjore të kualifikimit të përcaktuara nga ligji dhe është gjithmonë i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. UAMD ka krijuar infrastrukturën e duhur në funksion të studentëve me hapësira konform standardeve.</p>

<p>qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Auditorët dhe laboratorët janë kompletuar me bazë materiale të nevojshme. Lektorët vënë në dispozicion të studentëve leksionet e miratuara. Po punohet për publikimin e teksteve në fushën e asistentit dentar. I gjithë stafi akademik është kompletuar me personel me status Doktor i Shkencave dhe Master.</p> <p>Bashkëbisedimi, diskutimi, puna në grupe të vogla, nxisin mendimin krijues dhe kritik të studentit duke krijuar marrëdhënie interaktive me një respekt të ndërsjellë midis personelit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>Takimi me stafin, Zyrën e Burimeve njerëzore</i></p> <p><u>Evidenca Nr.73 Raport mbi Aktivitetet Kulturore, Shkencore dhe Artistike.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr 71 Buletini i aktiviteve-FSP-2021-2022.pdf</u></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i veprimtarisë akademike të personelit është i vazhdueshëm. Përveç vetvlerësimit që realizon çdo lektor kryej edhe vlerësimi nga departamenti dhe NjSBC. Janë përdorur pyetësorë të cilët plotësohen nga studentët në lidhje me aspektin akademik të lektorëve dhe procesin e mësimdhënies në përgjithësi.</p> <p>Rezultatet e përpunuara të anketimeve diskutohen në mbledhjen e departamentit. Vlerësimi i performacës është një formë tjetër e vlerësimit. Këto nxisin dhe i jepnin shtysë për reflektim, ndryshim pozitiv dhe përmirësim të mësimdhënies.</p> <p>Lektorët nga ana tjetër synojnë të marrin rezultate gjithmonë e më tepër në rrje nga ana e përfitimit të dijeve nga studentët. UAMD vlerëson në mënyrë periodike gjendjen e programit të studimit, cilësinë, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtarinë kërkimore shkencore, nivelin e përgjithshëm të rankimit të UAMD.</p> <p><i>Takimi me NjSBC, stafin, studentët</i></p> <p><u>Evidenca Nr.43.1 Pyetesor dhe relacion mbi mesimdhënien online.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.78 Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut.pdf</u></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>UAMD ka struktura të posaçme të ngritura për promovimin e përmirësimit të mësimdhënies. Veprimtaria e Drejtorive/Qendrave përcaktohet në rregullorë të miratuara nga Senati i UAMD. Ato promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> <p>Pjesëmarrja e personalitetve me zë në fushën e dentistrisë në aktivitetet e Universitetit ka ndikuar pozitivisht në informimin me të rejtat e fundit në kuadër të përbushjes së qëllimeve dhe objektivave të institucionit.</p> <p><i>Takimi me stafin</i></p> <p><u>Evidenca Nr.78 Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut.pdf</u></p>

Konkluzione	<i>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, ka eksperiencë të konsiderueshme në mësimdhënie si dhe aftësi profesionale të organizonin veprimtaritë e tyre të procesit mësimor, në funksion të përmbushjes së nevojave të studentëve. Vlerësimi i veprimtarisë akademike të personelit është i vazhdueshëm. Përveç vetvlerësimit që realizon çdo lektor kryet edhe vlerësimi nga departamenti dhe NjSBC. UAMD ka struktura të posaçme të ngritura për promovimin e përmirësimit të mësimdhënies. Pjesëmarrja e personalitetve me zë në fushën e dentistrisë në aktivitetet e Universitetit ka ndikuar poziivisht në informimin me të rejat e fundit në kuadër të përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Rregullorja e UAMD, Rregullorja e FSP, Rregullorja e programit të studimit "Ndihmës Dentist", rregullorja e provimeve të DSHTM, kanë përcaktuar qartazi kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve.</p> <p>Forma e vlerësimit të dijeve, aftësive dhe njohurive të përvetësuar nga studentët në orët mësimore është përcaktuar vetëm një formë vlerësimi, provimi me shkrim si në provimet e ndërmjetme, përfundimtare, detyrat e kursit/projektet. Sistemi i pikëzimit me 1000 pikë, i miratuar nga Senati Akademik, është forma e kontrollit dhe vlerësimit i cili konvertohet në notë. Studenti shlyen detyrimet akademike semestrale ose vjetore dhe vlerësohet me notë të konvertuar nga pikët e grumbulluara përgjatë provimeve të ndërmjetme (40% të vlerësimit), detyrave të kursit/projekteve (10% të vlerësimit), dhe provimit përfundimtar i cili ka 500 pikë në total (50% të vlerësimit përfundimtar), duke fituar në këtë mënyrë kreditet respektive. Minimumi i pikëve kaluese është 505 pikë. Studentët janë njohur me rregulloren e provimeve qysh në fillim të vitit akademik. Kalendar i provimeve i detajuar vihet në dispozicion të studentëve dhe ata kanë kohën e mjaftueshme për tu përgatitur. Rregullorja e provimit zbatohet nga gjithë stafi dhe studentët.</p> <p>Ruhet anonimati në tezën e provimit. Pas korrigjimit dhe feedback në rast kontestimi, komisioni ballafaqohet me studentin, tezën e plotësuar, siguron transparencë të plotë të vlerësimit dhe merr vendimin përfundimtar për vendosjen e notës. Në UAMD rezultatet hidhen në sistem 72 orë pas zhvillimit të provimit.</p> <p><i>Takimi me Drejtuesit, stafin</i></p>

	<p>Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf Evidenca Nr.102 Rregullore e laboratoreve.pdf Evidenca Nr.97 Rregullore e Mikrotezës në Fakulteti i Studimeve Profesionale.pdf</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimi e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të vitit akademik, lektori në orën e parë mësimore, informon studentët mbi modulën përkatës, përmbajtjen e lëndës, temat që do zhvillohen, metodologjinë e testimi e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, kohëzgjatjen dhe shtrirjen e modulit përgjatë semestrit. Ata njihen me literaturën që do të përdoret si dhe bazën materiale që do të vihet në dispozicion të tyre. Studentët kanë dijeni mbi formën e vlerësimit të njohurive të tyre, për sistemin e pikëzimit dhe ngarkesën e krediteve për çdo modul.</p> <p><i>Takimi me stafin</i> Evidenca Nr.123 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2019-2020.pdf Evidenca Nr.124 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2020-2021.pdf Evidenca Nr.125 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2021-2022.pdf</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në mënyra të ndryshme me vlerësim të ndërmjetëm nga java 7-8 dhe 15-16, detyrat e kursit sipas parashikimit në syllabus dhe provimi përfundimtar 2 javët e fundit.</p> <p>Vlerësimet formale në seminare realizohen në formën e diskutimeve, punës në grupe, diskutimeve apo rasteve klinike. Por një rëndësi të madhe i kushtohet aftësive profesionale prandaj dhe përgatitja praktike zë një kohë të konsiderueshme nga ana e studentit. Vlerësimi për këtë pjesë kryhet nëpërmjet detyrës së kursit.</p> <p>Kështu studentët kanë mundësi të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara teorike në praktikë.</p> <p><i>Takimi me stafin, sekretarinë</i> Evidenca Nr.97 Rregullore e Mikrotezës në Fakulteti i Studimeve Profesionale.pdf Evidenca Nr.137 Kopje e tezes se provimit final.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rregullorja e UAMD, Rregullorja e FSP, Rregullorja e programit të studimit "Ndhimës Dentist", rregullorja e provimeve të DSHTM, kanë përcaktuar qartazi kriteret dhe mënyrën e testimi e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Rregullorja e provimit zbatohet nga gjithë stafi dhe studentët. Studentët kanë dijeni mbi formën e vlerësimit të njohurive të tyre, për sistemin e pikëzimit dhe ngarkesën e krediteve për çdo modul.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas rregulloreve përkatëse të sipërpërmendura format dhe mënyrat e vlerësimit janë përcaktuar në syllabuset e lëndëve dhe u bëhen të ditura studentëve qysh në fillim të vitit akademik. Vlerësimi teorik dhe ai praktik përfshijnë seminare, detyra, projekte, pune laboratorike etj. Provimet e ndërmjetme me peshë 40% , projektet me peshë 10%, provimi përfundimtar me peshë 50% ndihmojnë studentët të jenë në kontroll dhe vlerësim të vazhdueshëm duke bërë të mundur aftësimim teoriko-praktik sa më të sukseshëm. Secili syllabus reflekton elementët e vlerësimit sipas një pikëzimi të standardizuar. Nxitja e të mësuarit të studentëve në mënyrë sistematike i ndihmon të përkushtohen në përfitimin e njohurive të tyre profesionale në fushën e asistentit dentar.</p> <p><i>Dokumenti i ofruar Fletë pikëzimi. Takimi me stafin</i></p> <p>Evidenca Nr.123 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2019-2020.pdf Evidenca Nr.124 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2020-2021.pdf Evidenca Nr.125 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2021-2022.pdf Evidenca Nr.107 Anketimi i studenteve.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UAMD ka investuar për krijimin e një sistemi të brendshëm elektronik. Ai ka aplikuar projektin Clean Score të vlefshëm deri më 31/12/2024. FSP ka staf të trajnuar për këtë qëllim si dhe personel të përgatitur nga DSHTM. Nëpërmjet këtij projekti realizohet korrigjimi i provimeve me alternativa përmes skanerave. Pyetjet shtjelluese me shkrim korrigjohen nga lektori i modulit më vete.</p> <p>Më parë është përdorur sistemi AULA e aktualisht është në funksion platforma e sekretarisë ESSE3 e ngritur nga RASH me sistemin e integruar elektronik Pitagora. Aty hidhen edhe pikëzimet nga vlerësimet e studentëve dhe lektori mund ta aksesojë atë për të rregulluar ndonjë gabim të kryer gjatë hedhjes, por vetëm pasi të ketë marrë miratimin nga personat përgjegjës.</p> <p><i>Takimi me stafin, sekretarinë, studentët</i></p> <p>Evidenca Nr.136 Marreveshje me Clean Score. trajnimi Clean Score.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar është përcaktuar si një provim përmbyllës pasi studenti ka grumbulluar pikëzimet e tjera individuale të vlerësimeve të ndërmjetme dhe të projekt/detyrave. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me rregulloret e miratuara më parë, syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Rezultatet e pikëzimeve të studentëve reflektohen në proces verbalin e modulit përkatës.</p> <p>Ai përmban të gjithë elementët ligjorë për të qenë i vlefshëm si për provimin për herë të parë por ashtu edhe për riprovimet. Komisionet e vlerësimit janë të miratuara në avancë. Njësia Bazë verifikon kontrollin e procesit të provimeve në fund të semestrit duke siguruar transparencë dhe rritur objektivitetin.</p> <p>Evidenca Nr.123 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2019-2020.pdf Evidenca Nr.124 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2020-2021.pdf Evidenca Nr.125 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2021-2022.pdf Evidenca Nr.137 Kopje e tezes se provimit final.pdf</p>




	<i>Takimi me stafin, studentët</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Numri i vogël i studentëve në programin e studimit "Ndihmës Dentist" në UAMD, mundëson komunikim të vazhdueshëm dhe të drejtepërdrejtë me studentët.</p> <p>Ata ndihmohen nga pedagogët me komente dhe sugjerime në mënyrë që të përmirësohen vazhdimisht. Personeli akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente/feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë vlerësimeve të ndërmjetme, realizimit të aktiviteteve dhe projekteve të kursit.</p> <p>Ata i këshillojnë dhe orientojnë për përmirësimin e procesit të të nxëniet në mënyrë që të rrisin kompetencat në të ardhmen. Por edhe gabimet e bëra në provim nga studentët, diskutohen për ti ditur ato dhe për tu përgatitur më mirë në provimet pasardhëse.</p> <p><u>Evidenca Nr.87 Mentorimi i studenteve dhe oraret e konsultimeve.pdf</u></p>
	<i>Takimi me stafin, studentët</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>Studentët verifikohen me kartë identiteti/ kartë studenti ditën e provimit para fillimit të tij. Çdo mjet apo material i palejueshëm si celular dhe të tjera të ngjashme të përdorura në provim, komunikimi me të tjerët, përbën shkelje dhe studentit përjashtohet nga provimi. Në ditët e provimit me shkrim, pas dhënies së tezës, nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë. Anëtarët e komisionit të provimit mbikqyrin gjatë gjithë kohës për zhvillimin korrekt të provimit, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit.</p> <p>Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, me përjashtim të Përgjegjësit të Departamentit, lektorit të lëndës dhe atij asistues. Testet janë të koduara dhe ruhet anonimat i plotë.</p> <p>Në identifikimin e plagjaturës veprohet sipas rregullores, projektet ose diploma anulohet dhe masat merreshin sipas nenit 117 të rregullores së UAMD.</p>
	<i>Dokumenti i ofruar Rregullore provimi. Takimi me stafin, studentët</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale, bazohet në meritë dhe jepet në kohë sipas përcaktimeve në rregulloren e programit. Rezultatet hidhen në sistem pas 72 orë të zhvillimit të provimit.</p> <p>Studentët sigurohen për transparencën e vlerësimit dhe marrjes së pikëzimeve sipas meritës. Kontenstimet kanë një feedback korrekt ku komisioni bashkë me studentin ballafaqojnë testin me shkrim dhe marrin vendim përfundimtar për rezultatin. Vlerësimi me notë varion nga 1-5 ku nota 5-10 janë kaluese. Nota është konvertuar nga pikëzimi që shkon maksimalisht në 1000 pikë. Me 505 pikë studentit quhet kalues. Forma e vetme e vlerësimit është ajo me shkrim. Afati maksimal i dorëzimit të procesverbalit nga pedagogu në sekretari është 7 ditë për provimet e ndërmjetme. <i>Dokumenti i ofruar Fletë pikëzimi.</i></p>
	<i>Takimi me stafin, studentët</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në	<p>Studentët marrin në kohë rezultatet e provimeve dhe nëse kanë ndonjë kërkesë për rishikim të testit ai vihet në dispozicion të studentit sipas nenit 71 të rregullores së UAMD, si dhe nenit 53 të rregullores së FSP. Më tej procedohet rast pas rasti sipas rregullores duke respektuar të drejtat e studentit si dhe trasnparencën e gjithë procesit.</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail : info@ascal.al

Tel : +355 (04) 22-43423

Web site : www.ascal.al

Faqe 26

statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<i>Takimi me stafin, studentët</i> Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në shumicën e rasteve kur ka patur kontestim të vlerësimit, ato janë qartësuar nga komisioni i vlerësimit. Në të kundërt studenti që paraqet ankesë në lidhje me rezultatin e provimit i drejtohet me kërkesë Njesisë Kryesore për zgjidhjen e problematikës së vlerësimit. Pas miratimit nga Njësia Kryesore ngrihet një komision i posaçëm për të rikorriguar provimin në prani të studentit jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës sipas rregulloreve nenit 71 të rregullores së UAMD, si dhe nenit 53 të rregullores së FSP. <i>Takimi me stafin, sekretarine</i> Evidenca Nr.109 Kerkese studenti per rishikim provimi, permiresim rezultati.pdf			
Konkluzione	<i>Vlerësimi teorik dhe ai praktik përfshinin seminare, detyra, projekte, pune laboratorike etj. UAMD ka investuar për krijimin e një sistemi të brendshëm elektronik. Ai ka aplikuar projektin Clean Score të vlefshëm deri më 31/12/2024. Numri i vogël i studentëve në programin e studimit "Ndihmës Dentist" në UAMD, mundëson komunikim të vazhdueshëm dhe të drejtepërdrejtë me studentët. Ata ndihmohen nga pedagogët me komente dhe sugjerime në mënyrë që të përmirësohen vazhdimisht. Studentët marrin në kohë rezultatet e provimeve dhe nëse kanë ndonjë kërkesë për rishikim të testit ai vihet në dispozicion të studentit sipas nenit 71 të rregullores së UAMD, si dhe nenit 53 të rregullores së FSP. Më tej procedohet rast pas rasti sipas rregullores duke respektuar të drejtat e studentit si dhe trasnparencën e gjithë procesit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Në planin mësimor në çdo lëndë/modul janë përcaktuar një numër orësh me qëllim formimin teorik dhe praktik të studentëve. Programi përbëhet prej Lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllese. Kurrikula e programit garanton marrjen e njohurive të nevojshme në mënyrë që studentët të jenë të aftë t'i zbatojnë ato në praktikën laboratorike në lëndën e Praktikës 1 dhe 2. Studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të asistencës dentare. <i>Dokumenti i ofruar Programi, plani mësimor, syllabuset.</i> <i>Takimi me stafin</i> Evidenca Nr.123 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2019-2020.pdf Evidenca Nr.124 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2020-2021.pdf

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail : info@ascal.al

Tel : +355 (04) 22-43423

Web site : www.ascal.al

Page 27

<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p><u>Evidenca Nr.125 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2021-2022.pdf</u></p> <p>Në Programin e studimit me karakter Profesional 2 vjeçar “Ndhimës Dentist” në veprimtaritë formuese janë parashikuar lëndë të tipit C dhe D, duke garantuar zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, etikës profesionale etj. Pavarësisht se në kurrikul zënë rreth 25% -30% të veprimtarive në përgjithësi ato kanë specifikat e tyre dhe ndikojnë ndjeshëm në formimin e përgjithshëm të studentëve krahas atij profesional</p> <p><i>Takimi me stafin, drejtuesit</i></p> <p><u>Evidenca Nr.03 Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë VKM nr.710, datë 1.12.2017.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.121 Dosja e programit te studimit (kurikula , plani mesimor, dhe personeli akademik).pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Çdo pedagog gjatë zhvillimit të procesit mësimor përveç dhënies së informacionit studentëve dhe ndërtimit të dijeve, orienton studentët për çështjet më të rëndësishme të trajtuara në orët mësimore.</p> <p>Studentët duke njohur objektivat e modulit fokusohen në elementët më të rëndësishëm për të fituar njohuri, aftësi, kompetenca të cilat vlerësohen në përfundim të lëndës. Ata kanë në dispozicion literaturë të përditësuar dhe lektorët përdorin metoda të ndryshme pedagogjike për të lehtësuar të nxënin e studentëve. Detyrimet përmbyllëse realizohen me sukses pasi studentët kanë një ndjekje në dinamikë përgjatë shtrirjes së modulit/lëndës me një kohëzgjatje të përcaktuar.</p> <p><i>Dokumenti i ofruar Programi, plani mësimor, syllabuset.</i></p> <p><i>Takimi me stafin</i></p> <p><u>Evidenca Nr.121 Dosja e programit te studimit (kurikula , plani mesimor, dhe personeli akademik).pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Studentëve u janë krijuar mundësi që të fitojnë aftësi profesionale falë edhe infrastrukturës së vënë në dispozicion nga UAMD. Duke qenë se numri i studentëve është i vogël mundësia për të punuar në grupe me 3-4 persona i ndihmon ata të fitojnë aftësi profesionale më me lehtësi. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash. Për module të caktuara të kurrikulës, studentët testohen t’i aplikojnë këto kompetenca në klinikat ku zhvillohen praktika.</p> <p>Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon grupet e studentëve në realizimin e detyrave dhe projekteve të ndryshme. Është parashikuar edhe hapja e laboratorit të dentistrisë përveç laboratorëve të tjerë funksionalë në dispozicion të studentëve ndihmës dentar. Po punohet për të gjetur mundësi për mobilitetin e studentëve.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p> <p><u>Evidenca Nr.123 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2019-2020.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.124 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2020-2021.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.125 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2021-2022.pdf</u></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe</p>	<p>Personeli akademik integron të reja më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që u jepen studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të mësimin. Fakulteti ka krijuar traditë të re, duke organizuar aktivitete të ndryshme, si tema të hapura, Konferenca</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail : info@ascal.al

Tel : +355 (04) 22-43423

Web site : www.ascal.al

Faqe 28




<p>teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Institucionale, ku fton pedagogë nga universitetet e tjera, profesionistë, staf akademik të brendshëm dhe të jashtëm, por bën të mundur edhe pjesëmarrjen e studentëve si për prezantime aktive por edhe si pjesëmarrës pasivë në fusha ndërdisiplinore. Nuk mungojnë Konferencat Studentore të përvitshme. Në këto aktivitete sillen të rejtat më të fundit të shkencës.</p> <p><i>Takimi me stafin, drejtuesit</i></p> <p><u>Evidenca Nr.73 Raport mbi Aktivitetet Kulturore, Shkencore dhe Artistike.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.71 Buletini i aktiviteteve-FSP-2021-2022.pdf</u></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në planin mësimor në çdo lëndë/modul janë përcaktuar një numër orësh me qëllim formimin teorik dhe praktik të studentëve. Programi përbëhet prej Lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbylëse. Studentët duke njohur objektivat e modulit fokusohen në elementët më të rëndësishëm për të fituar njohuri, aftësi, kompetenca të cilat vlerësohen në përfundim të lëndës. Duke qenë se numri i studentëve është i vogël mundësia për të punuar në grupe me 3-4 persona i ndihmon ata të fitojnë aftësi profesionale më me lehtësi. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbyljes së standardit</p>	<p>Nuk përmbyllet</p>	<p>Përmbyllet pjesërisht</p>	<p>Përmbyllet kryesisht</p>	<p>Përmbyllet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbylëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbylëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.</p>	<p>UAMD informon studentët mbi procedurat e mbrojtjes së diplomës me provim përfundimtar bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse të programeve të studimit. UAMD në Programin e studimit me karakter Profesional 2 vjeçar “Ndihmës Dentist” ka udhëzuar dhe informuar studentët të paktën 5 muaj përpara datës së provimit përfundimtar duke afishuar datat në stendën e Fakultetit su dhe në faqen zyrtare të UAMD. Provimi përfundimtar bëhet me shkrim me sistemin e pikëzimit me 1000 pikë i cili është sqaruar edhe më sipër që konvertohet në notë. Rezultatet e mbrojtjes së diplomës jepen në fund të ditës pasi është kryer provimi përfundimtar. Në programin me karakter profesional “Ndihmës Dentist”, diploma jepet kur studenti ka shlyer të gjitha detyrimet e tjera akademike. <i>Dokumenti i ofruar Rregullore Programi studimi.</i></p> <p><i>Takimi me sekretarinë</i></p> <p><u>Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.128 Shembull i Vlerësimit të një Praktike.pdf</u></p>




<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Studentët udhëzohen dhe sqarohen në mënyrë të vazhdueshme për çdo paqartësi për provimin përfundimtar nga lektorët mentorë që japin mësim në programin me karakter profesional “Ndhmës Dentist”. Gjatë semestrit të dytë, pedagogët e Lëndëve, organizojnë herë pas here takime me studentët për t’i udhëzuar për detyrimet përmbyllëse. Provimi me shkrim organizohet me pyetje me qarkim sipas lëndëve specifike. Studentët kanë informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij procesi dhe realizimin e tij.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p> <p>Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi profesional 2-vjecar në Ndhmës Dentist parashikon një provim final me shkrim me 4 teza të ndryshme me pyetje me qarkim. Komisioni i përcaktuar korrigjon tezat e provimit dhe proces verbalit dorëzohen brenda ditës. Tezat hartohen mbi njohuritë e dhëna gjatë vitit akademik duke përfshirë modulin në madhësinë dhe peshën e tij specifike që zë në program. <i>Takim me stafin, studentët</i></p> <p>Evidenca Nr.137 Kopje e tezes se provimit final.pdf Evidenca Nr.123 Syllabuset Ndhmes dentist v.a. 2019-2020.pdf Evidenca Nr.124 Syllabuset Ndhmes dentist v.a. 2020-2021.pdf Evidenca Nr.125 Syllabuset Ndhmes dentist v.a. 2021-2022.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>UAMD informon studentët mbi procedurat e mbrojtjes së diplomës me provim përfundimtar nëpërmjet personelit akademik që orienton dhe ndihmon studentët bazuar në fushat specifike të mbuluara. Në vlerësimin përfundimtar komisioni zbaton me korrektësi rregulloren e provimit për një testim të rregullt, sipas afateve kohore të përcaktuara dhe kritereve të vendosura. Studentët respektojnë rregulloren dhe marrin rezultatet në fund të ditës për provimin final.</p> <p><i>Dokumenti i ofruar Rregullore Programi studimi.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p> <p>Evidenca Nr.112 Njoftim i sekretarise per provimin final te diplomimit ND.pdf Evidenca Nr.137 Kopje e tezes se provimit final.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në FSP infrastruktura laboratorike dhe klinike e institucionit është e pajisur me materialet e duhura për të realizuar programin mësimor, aktivitetin e tij shkencor. Mund të përmendim laboratorët e infermierisë, kirurgjisë, bibliotekën, sallën e informatikës, etj, duke garantuar përfitime cilësore në mësimdhënie, në ambiente komode e funksionale në shërbim të studentëve.</p> <p>Klinikat dentare dhe institucionet mikpritëse për praktikat e studentëve, lejojnë aftësimin praktik të tyre pranë profesionistëve me pacientë realë.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët, bibliotekën</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Organizimi i provimeve dhe provimit përfundimtar bëhet në përputhje me rregulloret e UAMD, Fakultetit, Sekretarisë Mësimore Programit të studimit, Syllabuset e çdo lënde. Studenti shlyen detyrimet akademike vjetore dhe vlerësohet me pikë e cila konvertohet në notë duke fituar në këtë mënyrë kreditet respektive. <i>Dokumenti i ofruar Fletë pikëzimi.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, sekretarinë</i></p> <p>Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf</p>




<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar</p>	<p>Në përfundimin me sukses të ciklit të studimit "Ndihmës Dentist", studenti pajiset me (Çertifikatë Profesionale), suplementin e diplomës duke cilësuar ciklin dhe emërtimin e diplomës së marrë, sipas gjithë udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p>Studenti mund të marrë një kopje zyrtare të programit të studimit "Ndihmës Dentist", nëse është i interesuar. <i>Dokumenti i ofruar Çertifikata Profesionale.</i></p> <p><i>Takimi me stafin, studentët, sekretaria mësimore</i></p> <p><u>Evidenca Nr.119 Urdhër Nr. 323 date 22.10.2020 Regjistrimi i Formës së Diplomës Nd.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.120 Kopje e Suplementit te programit te studimit Ndhimes Dentist.pdf</u></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Sipas legjislacionit në fuqi sekretaria mësimore e UAMD ruan dokumentat e plota të studentëve në formë fizike, në hard-copy si dhe në databazën digitale të Universitetit.</p> <p>Sekretaria mësimore arkivon regjistrat bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, regjistrin me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave, suplementin e diplomës, listat e notave, dokumentacionin e aplikimit, etj.</p> <p><i>Dokumentat e ofruara nga sekretaria. Takimi me sekretaria mësimore</i></p> <p><u>Evidenca Nr.120 Kopje e Suplementit te programit te studimit Ndhimes Dentist.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.114 Shkrese QSHA regjistrimi diplomave.pdf</u></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD informon studentët mbi procedurat e mbrojtjes së diplomës me provim përfundimtar bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse të programeve të studimit. Programi profesional 2-vjeçar në Ndihmës Dentist parashikon një provim final me shkrim me 4 teza të ndryshme me pyetje me qarkim. Komisioni i përcaktuar korigjon tezat e provimit dhe proces verbalit dorëzohen brenda ditës. Sipas legjislacionit në fuqi sekretaria mësimore e UAMD ruan dokumentat e plota të studentëve në formë fizike, në hard-copy si dhe në databazën digitale të Universitetit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë</p>	<p>Mjediset ku zhvillohet veprimtaria akademike e UAMD lejojnë studentët të ndërthurin teorinë me praktikën. FSP inkurajon zhvillimin e metodave inovative të procesit pedagogjik duke e vendosur studentin në qendër të procesit mësimor, inkurajon të menduarin kritik, të studentëve, përgatitjen e tyre për tregun e punës dhe bashkëpunimin</p>




<p>të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>student-pedagog. Sallat e auditorëve, laboratorët, janë pajisur me mjetet e nevojshme teknologjike, çka mundësonin aplikimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe praktikës profesionale.</p> <p>Mendohet gjithmonë për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies duke kombinuar metodologjitë bashkëkohore si peer to peer, focus group, sondazhe, etj. <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>UAMD dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe pikave të tjera kritike të cilësisë mësimore, hartojnë kontrolle dhe anketime me studentë dhe stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie.</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi i mësimdhënies realizohet mbi bazën e disa instrumentave si: analizimi i kalendarit të aktiviteteve, pyetësi i vlerësimit të pedagogëve nga studentët, formulari i vetvlerësimit të performancës, pyetësi online për studentët nga Njësia Bazë.</p> <p><i>Dokumentat e ofruara nga NjSBC. Takimi me NjSBC</i></p> <p>Evidenca Nr.106 Formular i Vlerësimit për pedagogët nga studentët.pdf</p> <p>Evidenca Nr.107 Anketimi i studenteve.pdf</p> <p>Evidenca Nr.108 Transparenca e Rezultateve të Anketimeve të Studenteve.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies realizohet për të gjithë pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm. Rezultatet e anketave dhe pyetësorëve, bëhen të njohura për stafin individualisht. Analiza e gjerë ndahet me departamentet dhe dekanatin, në të cilin diskutohet në mënyrë konstruktive për problemet dhe pikat e forta.</p> <p><i>Takimi me NjSBC</i></p> <p>Evidenca Nr.106 Formular i Vlerësimit për pedagogët nga studentët.pdf</p> <p>Evidenca Nr.108 Transparenca e Rezultateve të Anketimeve të Studenteve.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>NJSBC si një njësi kyç, ka një rol thelbësor si promovuese në përmirësimin dhe zhvillimin e cilësisë së mësimdhënies duke nxitur stafin akademik për praktikave të mira të evidentuara nga studentët apo me mekanizmat e tjerë të vlerësimit të NJSBC.</p> <p><i>Takimi me NjSBC</i></p> <p>Evidenca Nr.78 Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut.pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Mjediset ku zhvillohet veprimtaria akademike e UAMD lejon studentët të ndërthurin teorinë me praktikën. FSP inkurajon zhvillimin e metodave inovative të procesit pedagogjik duke e vendosur studentin në qendër të procesit mësimor, inkurajon të menduarin kritik, të studentëve, përgatitjen e tyre për tregun e punës dhe bashkëpunimin student-pedagog. Monitorimi dhe vlerësimi i mësimdhënies realizohet mbi bazën e disa instrumentave si: analizimi i kalendarit të aktiviteteve, pyetësi i vlerësimit të pedagogëve nga studentët, formulari i vetvlerësimit të performancës, pyetësi online për studentët nga Njësia Bazë. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies realizohet për të gjithë pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit per bëhet prej profesionistesh me eksperiencë shume vjeçare në e fushën e stomatologjisë. Personeli akademik efektiv, ai me kontratë dhe personeli ndihmës akademik në Programin e studimit me karakter Profesional 2 vjeçar “Ndhmës Dentist” kanë formimin e duhur teorik dhe praktik për mbulimin e lëndëve të këtij programi duke përmbushur kërkesat ligjore në fuqi. Pedagogët përditësojnë njohuritë në mënyrë të vazhdueshme duke azhornuar studentët me të rejat e fundit të fushës. UAMD organizon sipas një programi të përvitshëm aktivitete të ndryshme ku marrin pjesë edhe studentët. <i>Dokumentat e ofruara nga Burimet Njerëzore. Takimi me stafin, Burimet Njerëzore</i> <u>Evidenca Nr.122 CV e stafit akademik me kontratë te programit te studimit.pdf</u>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Sipas kornizave ligjore personeli akademik efektiv përmbush të paktën 70% te ngarkesës mësimore. Personeli akademik full-time dhe ai part-time kanë një ngarkesë të përcaktuar sipas legjislacionit e cila pasqyrohet në orë dhe kredite. Ngarkesën më të madhe e kanë lektorët e brendshëm. Lektorët e jashtëm nuk duhet të kalojnë 120 orët e lejuara. Edhe lektorët e brendshëm kanë normativën e tyre të miratuar dhe ngarkesa është e planifikuar për secilin. <i>Dokumenti i ofruar Tabelat e stafit akademik. Takimi me stafin, drejtuesit</i> <u>Evidenca Nr.130 Te dhena tabelore per personelin akademik ne programin e studimit Ndhmes dentist.pdf</u>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	14 personat e angazhuar në Programin e studimit me karakter Profesional 2 vjeçar “Ndhmës Dentist” si Stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, kanë nënshkruar kontratën e punës ku një kopje është në institucion dhe kopja tjetër mbahet nga i punësuari. Universiteti kryen me përgjegjshmëri të gjitha detyrimet financiare si për pagesat e lektorëve por edhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në kohë dhe në mënyrë të rregullt. <i>Dokumentat e ofruara nga Burimet Njerëzore. Takimi me stafin, Burimet Njerëzore</i> <u>Evidenca Nr.80 Te dhena tabelore me ngarkesen e plote mesimore te stafit akademik ne te gjitha programe.pdf</u>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë	Në statut dhe rregullore të FSP janë përcaktuar kriteret e rekrutimit të personelit akademik, ndihmës apo personel administrativ në përmbushje të kritereve ligjore të përcaktuara në legjislacionin e Arsimit të Lartë. Vlerësohen dhe merren në konsideratë titujt akademikë, gradat shkencore, fusha dhe ngarkesa që do të mbulojë




<p>përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>kandidati. Përzgjedhja bëhet nga një komision i posaçëm, me një procedurë transparente për të gjithë kandidatët. Dosjet e paraqitura diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë për të gjykuar mbi aftësitë profesionale, kualifikimet themelore sipas kriterëve, kualifikimet shtesë dhe vizionin e perspektivës. Çdo i punësuar rregullon marrëdhëniet e tij me një kontratë pune individuale duke respektuar Kodin e Punës.</p> <p><i>Dokumentat e ofruara Statuti, Rreguloret e UAMD.</i> <i>Takimi me stafin, ZBNJ.</i> Evidenca Nr.04 Statuti i UAMD.pdf Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UAMD zbaton rregulloren e programit të studimit për angazhimin e Personelit Ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Lektorët me kohë të pjesëshme koordinojnë punën e tyre për realizimin e praktikave profesionale duke bashkëpunuar me mjekët stomatologë pranë DRSHD. Koordinatori i programit raporton për praktikat e realizuara.</p> <p><i>Dokumentat e ofruara nga Burimet Njerëzore. Takimi me stafin, ZBNJ.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>	<p>UAMD përditëson çdo vit akademik organigramën dhe ruan shpërndarjen e detyrave në secilin prej pjesëtarëve të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Të dhënat ruhen nga Përgjegjësi i Njësisë, në Dekanat si dhe në Zyrën e Cilësisë së Kurrikulës. Strukturat administrative dhe akademike kanë marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi. Komunikimi zyrtar bazohet në rregulloren për qarkullimin dhe arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD. <i>Dokumentat e ofruara nga Burimet Njerëzore.</i> <i>Takimi me drejtuesit, Njësinë administrative.</i></p> <p>Evidenca Nr.33.1 Organograma e UAMD, Programet UAMD.pdf</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Praktikat Profesionale 1 dhe 2 zhvillohen në bashkëpunim me institucione shëndetësore me të cilat UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi. Nëpërmjet bashkëpunimit me klinika të ndryshme dentare, studentëve u mundësohet aftësimi praktik duke u njohur me teknologjinë më të fundit dhe kontakt me klientë realë. Stafit akademik përgjegjës për praktikat ndihmon studentët të përbushin kompetencat e tyre sipas programit të shkollës. Profesionistët dhe pedagogët instruktajnë, udhëheqin dhe mbikëqyrin studentët në praktikën profesionale apo veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> <p><i>Takimi me studentët</i> Evidenca Nr.34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD.pdf</p>

<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Studentët shoqërohen nga personeli akademik i caktuar për ndjekjen e praktikave. Së bashku me profesionistët e klinikave dentare ata organizojnë punën duke i ndarë studentët në grupe të vogla në repartet e specifike. Mbarëvajtja e praktikave është një proces mbikqyrje, kontrolli dhe vlerësimi të vazhdueshëm. Studentët paraqitin rastet praktike pranë lektorëve të tyre duke bërë të mundur sjelljen e formularëve të praktikës të zhvilluar me një vlerësim individual paraprak nga vetë profesionisti (mjeku stomatolog, laboranti/asistenti dentar) që ka punuar me studentin gjatë praktikave. <i>Takimi me stafin, studentët</i></p> <p>Evidenca Nr.34 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD.pdf Evidenca Nr.96 Tabela me Marrëveshjet e Bashkëpunimit të FSP.pdf Evidenca Nr.95 Korrespondenca me Spitalin Rajonal Durrës.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Personeli akademik efektiv, ai me kontratë dhe personeli ndihmës akademik në Programin e studimit me karakter Profesional 2 vjeçar "Ndihmës Dentist" kanë formimin e duhur teorik dhe praktik për mbulimin e lëndëve të këtij programi duke përmbushur kërkesat ligjore në fuqi. Nëpërmjet bashkëpunimit me klinika të ndryshme dentare, studentëve u mundësohet aftësimi praktik duke u njohur me teknologjinë më të fundit dhe kontakt me klientë realë. Stafi akademik përgjegjës për praktikën ndihmon studentët të përmbushin kompetencat e tyre sipas programit të shkollës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Infrastruktura e UAMD siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve. Përveç auditorëve, laboratorëve, klinikave studentët kanë mundësinë të shfrytëzojnë edhe sallën e bibliotekës. Klasat e ndriçuara, me sisteme ngrohje-ftohje, me hapësira të bollshme, janë të pajisura me kompjutera dhe video projektor, internet, tabela, e bazë materiale të duhur për zhvillimin e aktivitetit mësimor, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentet, vizita në UAMD, auditore, laboratore</i></p> <p>Evidenca Nr.42.1 Infrastruktura Currila+Kampus 2019.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete</p>	<p>UAMD ka mundësuar që praktikën profesionale të zhvillohen pranë klinikave dentare private në Durrës, pranë DSHRD. Mjediset e këtyre institucioneve vihen në dispozicion të studentëve ku ata bashkë me</p>




<p>elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>stafin e klinikës punojnë me pacientë/klientë në poltronat e pajisura me gjithë bazën materiale të domosdoshme. Në universitet studentët kanë në dispozicion laboratorët e infermierisë dhe kirurgjisë për zhvillimin e moduleve ku baza materiale shfrytëzohet për studentët Ndhimës dentar. Por vënia në funksion e laboratorit të dentistrisë do t'i ndihmonte edhe më tepër këta studentë. Studentët hulumtojnë literaturë në gjuhën shqipe dhe atë të huaj në Bibliotekën e UAMD.</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p><i>Takimi me stafin, studentët</i> Evidenca Nr.48 Informacione per biblioteken UAMD.pdf Evidenca Nr.50 Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit.pdf Evidenca Nr.52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme.pdf Evidenca Nr.42.1 Infrastruktura Currila+Kampus 2019.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>UAMD vë në dispozicion Sallën e informatikës, një mjedis tjetër i cili i lejon studentëve të përdorin programe të ndryshme për studim, përgatisin detyra kursi dhe projekte, të bëjnë teste mbi njohuritë e tyre të fituara. Ky ambient si të gjithë ambientet e tjera ka akses me lidhje internet WiFi të sigurt dhe me shpejtësi të lartë. Qëllimi I teknologjisë është të mbështesë inovacionin në fushën e kërkimit shkencor dhe të mësimdhënies/mësimnxënies, asistimi i komunitetit universitar, staf e studentë, që të përdorin në mënyrë efikase shërbimet në dispozicion <i>Takimi me stafin, studentët, vizita në institucion</i> Evidenca Nr.14 Strategji TIK 2020-2025.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Infrastruktura e UAMD siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve. UAMD ka mundur që praktikat profesionale të zhvillohen pranë klinikave dentare private në Durrës, pranë DSHRD. Mjediset e këtyre institucioneve vihen në dispozicion të studentëve ku ata bashkë me stafin e klinikës punojnë me pacientë/klientë në poltronat e pajisura me gjithë bazën materiale të domosdoshme. UAMD vë në dispozicion Sallën e informatikës, një mjedis tjetër i cili i lejon studentët të përdorin programe të ndryshme për studim, të përgatisnin detyra kursi dhe projekte, të bëjnë teste mbi njohuritë e tyre të fituara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjediset e posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni siguron literaturë bazë dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe të huaj. Pedagogët u ofrojnë studentëve materiale në formë cikli leksionesh të përgatitura posaçërisht konform tematikës së modulit në gjuhën shqipe.</p> <p><i>Takimi me safin e bibliotekës, studentët</i></p> <p><u>Evidenca Nr.54 Lista e paketave U-Library.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.50 Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka 3 Biblioteka. Ato disponojnë një numër të mjaftueshëm botimesh të cilat studentët mund ti aksesojnë në formë fizike dhe elektronike. Kanë hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë apo pas procesit mësimor, edhe në fundjavë. Orari i shërbimit është në përshtatje me orarin mësimor dhe nevojave të studentëve.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët, punonjësit e bibliotekës</i></p> <p><u>Evidenca Nr.54 Lista e paketave U-Library.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.50 Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka në dispozicion të studentëve rreth 12 mijë tituj në shqip dhe gjuhë të huaj, në fond fizik dhe atë elektronik. Titujt në bibliotekë janë klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave. Gjithashtu në bibliotekë depozitohen edhe materialet e sygjera nga pedagogët për studentët, punimet, materialet didaktike etj. Literatura është bashkëkohore e 5-10 viteve të fundit. Kapaciteti deri 126 vende, kënde pune, kompjutera me akses interneti. Koleksionet e revistave shkencore janë prezente në bibliotekat e UAMD. <i>Takimi me punonjësit e bibliotekës</i></p> <p><u>Evidenca Nr.69 Te dhena te plota per Infrastrukturen e FSP dhe ne funksion te programit te studimit 2022.pd</u></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Shërbimi i bibliotekës ofrohet falas për stafin akademik të universitetit dhe për çdo student. Përveç materialit fizik studentët kanë akses edhe në Platformat online. Studentët marrin informacionin e duhur jo vetëm nga sygjerimet e pedagogëve por edhe duke hulumtuar në mënyrë individuale dhe të pavarur.</p> <p><i>Takimi me studentët</i></p>

	<p>Evidenca Nr.52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme.pdf</p> <p>Evidenca Nr.53 "Digital Library" - UAMD.pdf</p> <p>Evidenca Nr.48 Informacione per biblioteken UAMD.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>UAMD ka ngritur 3 biblioteka një investim i rëndësishëm në shërbim të stafit dhe studentëve. Bibliotekat kanë të instaluar sistemin COBISS duke bërë të mundur katalogimin e informacioneve bibliografike. Disponohen edhe CD, DVD të cilat janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit. Sistemi mundëson shfrytëzim pa kufi nga ana komunitetit të UAMD në EBSCO dhe burime të tjera të hapura. Njëkohësisht bibliotekat janë të pajisura me literaturë cilësore në fushën e stomatologjisë. Aty gjendeshin punimet shkencore të stafit dhe të studentëve. <i>Takimi me stafin, studentët</i></p> <p>Evidenca Nr.69 Te dhena te plota per Infrastrukturen e FSP dhe ne funksion te programit te studimit 2022.pd</p> <p>Evidenca Nr.28 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i bibliotekës dhe sallës së kompjuterave është ai zyrtar dhe i vënë plotësisht në shërbim të kërkesave të studentëve dhe stafit akademik. Në periudha të veçanta të vitit akademik, biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare të zgjata, ku nëse aksesohet jashtë orareve zyrtare të funksionimit të saj, caktohet një student përgjegjës i cili menaxhon funksionimin e bibliotekës gjatë këtij orari. Ndërsa aksesimi në libraritë online është pa limit gjatë gjithë vitit akademik.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët, punonjësit e bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>Bibliotekat menaxhohen nga 8 persona përgjegjës. Oraret e përditshme 8.00-12.00 dhe në fundjavë i ndihmojnë studentët të shfrytëzojnë kohën e tyre në këto mjedise në një diapazon të gjerë. Duke qenë se biblioteka pasurohet me tituj të rinj herë pas here edhe interesi nga komuniteti i UAMD është i madh. Ata i drejtohen personave përgjegjës të cilët janë të kualifikuar dhe aksesojnë me shpejtësi materialet të cilat i vihen në dispozicion të interesuarve. Kërkesat për tituj të rinj përditësohen vazhdimisht.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët, stafi i bibliotekës</i></p> <p>Evidenca Nr.55 Kalendar i bibliotekës ne fundjave.pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguron literaturë bazë dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe të huaj. UAMD ka në dispozicion të studentëve rreth 12 mijë tituj në shqip dhe gjuhë të huaj, në fond fizik dhe atë elektronik. Titujt në bibliotekë janë klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave. Kapaciteti deri 126 vende, kënde punë, kompjutera me akses interneti. Koleksionet e revistave</i></p>

	<i>shkencore janë prezente në bibliotekat e UAMD. Duke qenë se biblioteka pasurohet me tituj të rinj herë pas here edhe interesi nga komuniteti i UAMD është i madh.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	<p>UAMD ka një sistem të brendshëm menaxhimi të të dhënave të studentëve manualisht dhe elektronikisht. Qysh nga momenti i regjistrimit të dhënat pasqyrohen në sistemin ESSE3 nga sekretaria mësimore gjatë gjithë kohës së studimit deri në diplomim. Çdo student ka numrin e tij të matrikullimit si një e dhënë e rëndësishme për identifikim. Çdo student ka kartën e studentit dhe librezën e studentit. Sipas udhëzimeve të MAS dhe rregulloreve të UAMD dokumentacion themelor për studentët është: regjistri themeltar i studentit, regjistri i arritjeve akademike me rezultatet përkatëse për secilin student, regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikateve sipas emërimit të tyre. Sipas afateve kohore të përcaktuara dokumentacioni ruhet në arkivën e Shtetit dhe atë të UAMD.</p> <p><i>Takimi me stafin IT, Studentët</i></p> <p>Evidenca Nr.32 Sistemi PITAGORA (RASH).pdf</p> <p>Evidenca Nr.30 Licensimi i programeve kompjuterike.pdf</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>UAMD administron dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit me një sistem të brendshëm menaxhimi. Dokumentacioni individual dhe kontratat e punës ruhen në zyrën e burimeve njerëzore sipas rregullores përkatëse. Zyra e financës gjithashtu mban dokumentacion të rregullt mbi të ardhurat dhe shpenzimet, pagat dhe pagesat e sigurimeve shëndetësore dhe ato shoqërore të të punësuarve, shpenzimet për bazën materiale si dhe për trajnimet kërkimore shkencore etj. Departamenti ruan dokumentacionin e ngarkesës, syllabuseve, kalendarët e provimeve me komisionet përkatëse, raportet vjetore, raportet e akreditimeve, etj Regjistrat dhe procesverbalet e provimeve ruhen në sekretari. Portali ESSE3 është një tjetër vend ku gjenden informacione në lidhje me aktivitetin e secilit pedagog. <i>Takimi me stafin, ZBNJ.</i></p> <p>Evidenca Nr.32.1 Sistemi AULA.pdf</p> <p>Evidenca Nr.32 Sistemi PITAGORA (RASH).pdf</p>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të	<p>Platforma është një sistem shumë lehtësues që ndihmon si stafin ashtu edhe studentët për informacione 2 palëshe. Të gjithë pedagogët dhe studentët kanë llogaritë e tyre personale për akses të dhënë nga</p>


gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	universiteti. Faqja zyrtare tri gjuhëshe (shqip, anglisht, italisht) e Universitetit (https://uamd.edu.al/) siguron informacion edhe për publikun. Përdorimi i stendave informuese, fletëpalosjeve, manualeve dhe formave të tjera informuese vihen në funksion të studentëve dhe stafit. <i>Takimi me stafin IT, studentët</i>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Një rol të rëndësishëm ka mirëmbajtja e sistemit të platformës online e cila është funksionale dhe për këtë kujdeset IT që është në dispozicion në çdo moment. Platforma mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni ndërmjet personelit dhe studentëve. Studentët kanë akses për përdorim, marrje informacioni në kohë reale të materialeve në modulet e programit që studenti frekuenton. Sistemi Pitagora lejon studentët të marrin informacion të shpejtë mbi provimet dhe rezultatet e tyre. <i>Takimi me stafin, studentët</i> <u>Evidenca Nr.28 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit.pdf</u>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në praktikën e UAMD sigurohen analizime dhe vlerësime në formën e raporteve të monitorimit për çdo anëtar të stafik akademik si dhe për mbarëvajtjen e sistemit. Për pedagogët e rinj realizohen trajnime në mënyrë që të sigurohet një përdorim i mirë të platformës. <i>Takimi me stafin e IT</i> <u>Evidenca Nr.32 Sistemi PITAGORA (RASH).pdf</u>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Faqja zyrtare e UAMD është aktive në 3 gjuhë; shqip, anglisht dhe italisht. Informacioni në shqip është i kompletuar në të gjitha rubrikat, me gjuhët e tjera është në përditësim. Studentët dhe të gjithë të interesuarit mund të hyjnë lehtësisht dhe të marrin informacione për programet dhe aktivitetin akademik të Universitetit. UAMD jep informacione në rrjetet sociale duke promovuar, shpërndarë informacione në kohë reale për të gjithë. <i>Takimi me stafin IT</i> <u>Evidenca Nr.31 Faqja zyrtare UAMD.pdf</u>			
Konkluzione	<i>UAMD ka një sistem të brendshëm menaxhimi të të dhënave të studentëve manualisht dhe elektronikisht. UAMD administron dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit me një sistem të brendshëm menaxhimi. Zyra e financës gjithashtu mban dokumentacion të rregullt mbi të ardhurat, pagat dhe pagesat e sigurimeve shëndetësore dhe ato shoqërore të të punësuarve, shpenzimet për bazën materiale si dhe trajnimet kërkimore shkencore etj. Platforma mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni ndërmjet personelit dhe studentëve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X




Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UAMD sipas statutit dhe rregulloreve të tij planifikon dhe parashikon kostot dhe mundësitë e mbështetjes financiare për menaxhimin adekuat të burimeve financiare në funksion të universitetit dhe studentëve. Menaxhimi i këtyre burimeve vihet në dispozicion të përmirësimit të infrastrukturës dhe mirëmbajtjes së saj, zhvillimit normal procesit mësimor. Përcaktohen kostot sipas cikleve të plota të studimit dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit menaxhon të ardhurat konform legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar udhëzimet e UAMD. Evidenca Nr.63 Plani Financiar Vjetor i Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf Evidenca Nr.64 Raport Vjetor UAMD 2020-2021.pdf Evidenca Nr.62 Raporti financiar UAMD.pdf <i>Takimi me Zyrën financiare</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Raporti financiar përshkruan planin e financimit për të gjitha kostot e një programi studimi sipas zërave në shërbim të realizimit të programit që nga shërbimet operative, kostot e burimeve njerëzore, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, shpenzimet për literaturën e bibliotekës, kërkimin shkencor etj. <i>Takimi me Zyrën financiare</i> Evidenca Nr.67 Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të s.pdf Evidenca Nr.68 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit (kostot e programit Ndihmes Den.pdf
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Auditimi është një proces i përvitshëm. UAMD përpilon pasqyrat financiare të cilat lidhen me gjendjen financiare të universitetit, masën e realizimit të Projekt-Buxhetit të përcaktuar. Po ashtu hartohet edhe raporti i analizës financiare për të paktën 3 vitet e kaluara duke evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si dhe nivelin e shpenzimeve. Relacioni mbi projekt buxhetin afatmesëm dhe afatgjatë hartohet në mënyrë periodike nga njësitë përgjegjëse të UAMD. Evidenca Nr.67 Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të s.pdf

	<u>Evidenca Nr.25 Raporti i Veprimtarise Audituese V.A. 2013-2018.pdf</u> <i>Takimi me Zyrën financiare</i>			
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Raporti vjetor i UAMD, përmbante buxhetin e miratuar për programin e studimit "Ndihmës Dentist". Raporti i bëhet i ditur njësisë bazë. Në vetvete raporti ka si qëllim kontrollin dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit të të gjitha cikleve, objektivat dhe investimet e nevojshme afatmesme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor duke u bazuar në kërkesat financiare të secilit departament të parashtruara çdo vit. <i>Takimi me Zyrën financiare</i> <u>Evidenca Nr.67 Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të s.pdf</u>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Institucioni ka një gjëndje të qëndrueshme financiare pa detyrime ndaj individëve të tretë, organizata, banka apo organe tatimore. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit harton në mnyrë periodike projekt buxhetin afatmesëm dhe afatgjatë të UAMD. Planifikohen rrugët e financimit të investimeve duke identifikuar burimet e mundshme të gjenerimit të të ardhurave. <i>Takimi me Zyrën financiare</i> <u>Evidenca Nr.85 Planet për të Ulur Vartësinë Financiare.pdf</u>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka një gjëndje të qëndrueshme financiare. UAMD sipas statutit dhe rregulloreve të tij planifikon dhe parashikon kostot dhe mundësitë e mbështetjes financiare për menaxhimin adekuat të burimeve financiare në funksion të universitetit dhe studentëve. Raporti financiar përshkruan planin e financimit për të gjitha kostot e një programi studimi sipas zërave në shërbim të realizimit të programit që nga shërbimet operative, kostot e burimeve njerëzore, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, shpenzimet për literaturën e bibliotekës, kërkimin shkencor etj. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit harton në mnyrë periodike projekt buxhetin afatmesëm dhe afatgjatë të UAMD.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni garanton nëpërmjet Statutit të UAMD, rregullores së UAMD, rregullores së FSP, rregullores së programit të studimit "Ndihmës Dentist" zbatimin e politikave dhe procedurave në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kriteret dhe modalitetet e pranimit të studentëve, u bëhen me dije aplikantëve përgjatë periudhës së informimit. <i>Dokumentat e ofruara për Rregulloret.</i> <i>Takimi me stafin, sekretarinë, studentët</i> Evidenca Nr.04 Statuti i UAMD.pdf Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregullorja e programit përcakton procedurën e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentit, diplomimin, duke hartuar politika që garantojnë barazinë e studentëve. Kandidatët maturan të duhet të kenë notën mesatare të përcaktuar sipas VKM për tu pranuar çdo vit në programin e studimit "Ndihmës Dentist" Ata aplikojnë si gjithë maturan të tjerë në portalin https://ualbania.al/ <i>Takimi me stafin, sekretarinë, studentët</i> Evidenca Nr.110 Kriteret e pranimit te studenteve dhe kuotat.pdf
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Regjistrimi në institucion i studentit fitues për programin ku ka aplikuar, realizohet duke respektuar renditjen sipas pikëzimit në portalin shtetëror. <i>Takimi me stafin, sekretarinë, studentët</i> Evidenca Nr.110 Kriteret e pranimit te studenteve dhe kuotat.pdf
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kushtet dhe procedurat e transferimit dhe njohjes së krediteve, janë të përcaktuara qartazi në rregulloren e FSP. <i>Takimi me drejtuesit</i> Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf Evidenca Nr.90 Urdher per ngritjen e komisionit te tranferimit.pdf
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e	Çdo vit akademik publikon kriteret e veçanta për shtresa në nevojë si p.sh kandidatët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Institucioni i UAMD zbaton rregulloren e

kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	studentëve me aftësi të kufizuar duke u siguruar atyre shërbime lehtësuese. <i>Takimi me drejtuesit, zyrën juridike</i> <u>Evidenca Nr.21 Rregullore studente me aftesi te kufizuar.pdf</u>								
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Studentët me mesatare maksimale në hyrje gëzojnë të drejtën e fitimit të bursës për studentët, në UAMD. Institucioni zhvillon akime informuese me maturantet dhe jep udhëzime në lidhje me programin e studimit. Studentët mund të përfitojnë nga ky grant nëse rezultatet e tyre janë të shklqyera gjatë gjithë viteve të studimit për çdo program studimi pa dallim. Edhe studentët që plotësojnë kriteret e studentit nga shtresa sociale në nevojë, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave, dhe janë shpallur fitues përfitojnë bursë studimi. <i>Takimi me drejtuesit, zyrën juridike, studentët</i> <u>Evidenca Nr.40 Takime informuese me Maturantet dhe Udhezues te Programit te studimit.pdf</u>								
Konkluzione	<i>Kriteret dhe modalitetet e pranimit të studentëve, u bëhen me dije aplikantëve përgjatë periudhës së informimit. Rregullorja e programit përcakton procedurën e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentit, diplomimin, duke hartuar politika që garantojnë barazinë e studentëve. Kandidatët maturantë duhet të kenë notën mesatare të përcaktuar sipas VKM për tu pranuar çdo vit në programin e studimit "Ndihmës Dentist" Ata aplikojnë si gjithë maturantët e tjerë në portalin https://ualbania.al/ Institucioni i UAMD zbaton rregulloren e studentëve me aftësi të kufizuar duke i siguruar atyre shërbime lehtësuese.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rregullorja e FSP ka të përcaktuara kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës. Secili pedagog jep informacion që orën e parë mbi syllabusin e modulit dhe studentët njihen me të dhe janë të informuar mbi çdo element të tij. Studenti ka akses në platformë ku mund të shikojë rezultatet e provimeve dhe sipas krediteve të marra mundësinë për të kaluar në vitin pasardhës. M.gj.th. kontakti direkt me sekretarinë dhe me pedagogun mentor realizohet kur studentit ka nevojë për informacion të detajuar. <i>Dokumentat e ofruara për Rregulloret.</i> <i>Takimi me drejtuesit, stafin, studentët</i>

	<p><i>Evidenca Nr.40 Takime informuese me Maturantet dhe Udhezues te Programit te studimit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca Nr.110 Kriteret e pranimit te studenteve dhe kuotat.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni garanton nëpërmjet Statutit të UAMD, rregullores së UAMD, rregullores së FSP, rregullores së programit të studimit "Ndihmës Dentist" informacion të plotë dhe të detajuar mbi procesin e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme, programin e studimit, procesin mësimor, rregulloret e UAMD, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor.</p> <p><i>Takimi me drejtuesit stafin, studentët</i></p> <p><i>Evidenca Nr.04 Statuti i UAMD.pdf</i></p> <p><i>Evidenca Nr.05 Rregullore e UAMD.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e FSP, rregullorja e programit të studimit "Ndihmës Dentist", syllabuset e moduleve kanë të përcaktuara kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Vlerësimi me pikë konvertohet me notë. Vlerësimet e ndërmjetme dhe vjetore zhvillohen bazuar rregullores së provimeve. Studentët vlerësohen si në aspektin teorik dhe në atë praktik me punimet e tyre gjatë orëve laboratorike dhe praktikave klinike në Institucione dentare.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p> <p><i>Evidenca Nr.97 Rregullore e Mikrotezës në Fakulteti i Studimeve Profesionale.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Provimi përmbyllës finalizohet me provimin e diplomës. Studentët informohen në lidhje me procesin e vlerësimit nëpërmjet publikimit të rregullores së provimit përfundimtar si dhe informimit nga lektori përgjegjës. Datat afishohen në stenda dhe reklamohen në sistemin e platformës digjitale. Studentët duhet të regjistrohen në provimin përfundimtar.</p> <p><i>Takimi me drejtuesit, stafin, studentët</i></p> <p><i>Evidenca Nr.112 Njoftim i sekretarise per provimin final te diplomimit ND.pdf</i></p> <p><i>Evidenca Nr.137 Kopje e tezes se provimit final.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Informimi i maturantëve realizohet sipas një axhende të përcaktuar më parë nga MAS në shkollat e mesme ose ambiente që lejojnë takime me grupe të mëdha studentësh. Grupet e punës janë të përbera nga pedagogë të programit të studimit Ndihmës Dentar por edhe me angazhimin e studentëve apo të diplomuarve në këtë program. Ata prezantojnë UAMD programin e studimit, shpërmdajnë fletë palosje me një slogan tepër tërheqës, me informacione të rëndësishme mbi organizimin dhe funksionimin e universitetit, arsyes përse duhet zgjedhur dhe studjuar aty. Informacionet mund të merren gjithashtu nga faqja e UAMD ose rrjetet sociale. Studentët vlerësohen si në aspektin teorik dhe në atë praktik me punimet e tyre gjatë orëve laboratorike dhe praktikave klinike në Institucione dentare.</p> <p><i>5 Takimi me drejtuesit</i></p> <p><i>Evidenca Nr.40 Takime informuese me Maturantet dhe Udhezues te Programit te studimit.pdf</i></p>

Konkluzione	<i>Rregullorja e FSP ka të përcaktuara kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës. Provimi përmbyllës finalizohet me provimin e diplomës. Informimi i maturantëve realizohet sipas një axhende të përcaktuar më parë nga MAS në shkollat e mesme ose ambiente që lejojnë takime me grupe të mëdha studentësh.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët janë të informuar në lidhje me strukturën, organizimin e procesit mësimor, orët e teorisë dhe praktikës, si edhe sezonet e provimeve nëpërmjet kalendarit akademik të prezantuar nga përgjegjësi i programit si dhe në faqen zyrtare të institucionit. <i>Takimi me studentët</i> <u>Evidenca Nr.40 Takime informuese me Maturantet dhe Udhezues te Programit te studimit.pdf</u>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Planet mësimore, lëndët dhe modulet, miratohen çdo vit dhe studentëve u vihen në dispozicion nga secili pedagog i modulit. Për veprimtaritë formuese studentët informohen në vazhdimësi. <i>Takimi me stafin, studentët</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Qendra e karrierës dhe Alumnit në UAMD ka një rëndësi të veçantë sepse ajo koordinon punën në lidhje me mundësitë e mbështetjes për punësim të të diplomuarve si Ndihmës Dentar dhe programet e tjera të ofruara nga UAMD. Studentët ndihmohen të përpilojnë një CV, një letër interesi, të jenë të përgatitur për një intervistë pune, këshillim të plotë karriere. Kjo zyrë mban kontaktet e studentëve por edhe të klinikave që mund të kenë nevojë për plotësim të stafit të tyre me profesionistë të diplomuar si Ndihmës Dentar. <i>Takimi me QKA, stafin, studentët</i> <u>Evidenca Nr.84 Udhezues nga zyra Karrieres - aplikim pune.pdf</u> <u>Evidenca Nr.100 Njoftime ne rrjetet sociale te FSP.pdf</u>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën,	Stendat dhe platforma përdoren si burim informacioni për afishimin e orarit, provimet, njoftimet nga UAMD. Sinjalistika ndihmon në orientimin e duhur në institucion për sallat, laboratorët, administratën, bibliotekat, ambientet e tjera ndihmëse. Sekretaria është njësi që bën një lidhje të vazhdueshme me të gjithë grupet e interesit si studentë,

infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>pedagog, drejtues, administratë, financë, punonjës IT, punonjës biblioteke, punonjësit mbështetës, të interesuarit e tjerë.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> <p>Evidenca Nr.123 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2019-2020.pdf</p> <p>Evidenca Nr.124 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2020-2021.pdf</p> <p>Evidenca Nr.125 Syllabuset Ndhimes dentist v.a. 2021-2022.pdf</p> <p>Evidenca Nr.99 Orari mesimor i tre viteve te fundit.pdf</p> <p>Evidenca Nr.87 Mentorimi i studenteve dhe oraret e konsultimeve.pdf</p>			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit me Institucione të ndryshme për praktikat e studentëve përditsohen sipas afateve të nënshkrimit. Numri i vogël i studentëve lejon pranimin e tyre me lehtësi nga klinikat dentare por edhe mundësinë për punësimin e tyre të pjesshëm gjatë studimeve dhe me kohë të plotë pas diplomimit. Praktikrat monitorohen dhe mbikqyren në vazhdimësi dhe merret një feedback nga profesionistët e terrenit për studentët.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Studentët janë të informuar në lidhje me strukturën, organizimin e procesit mësimor, orët e teorisë dhe praktikës, si edhe sezonet e provimeve nëpërmjet kalendarit akademik të prezantuar nga përgjegjësi i programit si dhe në faqen zyrtare të institucionit. Qendra e karrierës dhe Alumnit në UAMD ka një rëndësi të veçantë sepse ajo koordinon punën në lidhje me mundësitë e mbështetjes për punësim të të diplomuarve si Ndhimës Dentar dhe programet e tjera të ofruara nga UAMD. Praktikrat monitorohen dhe mbikqyren në vazhdimësi dhe merret një feedback nga profesionistët e terrenit për studentët.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit	<p>Institucioni i UAMD, në stukturën e tij disponon zyrën e kryesekretarisë mësimore, ku ruhen, mbledhen të dhëna të cilat përpunohen në statistika vjetore me numrin e studentëve në hyrje, studentët aktivë sipas viteve, kalueshmërinë, largimet, jo aktivët dhe të diplomuarit për çdo program studimi.</p> <p><i>Dokumentat e ofruara Rregjistrat themeltarë.</i></p> <p><i>Takimi me sekretarinë</i></p>




<p>akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	
<p>Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Informacioni konfidencial ruhet në kohë reale dhe menaxhohet në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave nga sekretaria mësimore. Përveç ruajtjes së këtyre të dhënave në sistemin online, të dhënat dhe informacionet ruhen në formë të shkruar në regjistrat themeltarë të programit të studimit. Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave, në kushte sigurie të plotë, persona të autorizuar në varësi të detyrës kanë të drejtë dhe detyrim të hedhin dhe modifikojnë informacionin. Institucioni harton një raport vjetor gjithëpërfshirës, për të gjitha njësitë dhe programet që ofron. Në këtë raport analizohet edhe cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sugjerohen masa për përmirësimin e cilësisë. ZKA nxjerr statistika duke bashkëpunuar me sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Takimi me sekretarinë</i> Evidenca Nr.104 Rregullore sekretarise mesimore FSP.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Universiteti ka hartuar politika dhe procedura të qarta për menaxhimin e informacionit dhe dokumentacionit lidhur me studentët. Këto përfshijnë kontrollin periodik të përvitshëm me standarde të përshtatshme për sigurinë dhe saktësinë e informacionit. Sistemet teknologjike të universitetit ndihmojnë në monitorimin dhe dokumentimin e veprimtarisë së studentëve në mënyrë të efektshme. Këto sisteme janë të sigurta dhe ofrojnë mundësi për shkëmbimin e të dhënave në mënyrë të mbrojtur. Staf i trajnuar ka njohuritë e duhura mbi procedurat e institucionit dhe është i aftë për të kryer kontrollin e nevojshëm dhe dokumentimin e duhur. Auditimet dhe vlerësimet periodike institucioni i kryen duke siguruar efektivitetin dhe saktësinë e sistemeve të menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit. Këto vlerësime bëhen në mënyrë objektive dhe përfshijnë feedback nga personeli dhe studentët.</p> <p><i>Takimi me sekretarinë</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në Institucionin e UAMD, Njësia përgjegjëse për programin e studimit dhe grupet e punës bashkëpunojnë për hartimin e raporteve analitike, të cilat janë thelbësore për të përmirësuar cilësinë e programeve dhe për të siguruar standardet e akreditimit. Këto raporte përmbajnë analiza të hollësishme mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, si dhe shkallën e suksesit në punësim pas përfundimit të studimeve. Fillimisht, kryhet një analizë e hollësishme e profileve dhe cilësisë së studentëve që hyjnë dhe dalin nga programi i universitetit UAMD. Kjo analizë është e rëndësishme për të vlerësuar përputhjen e programit me pritshmëritë dhe për të ndërmarrë masa për përmirësim nëse është e nevojshme. Pastaj, bëhen vlerësime të pavarura për të vlerësuar cilësinë e punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve. Përmes sondazheve të punëdhënësve dhe analizave të kryera nga Zyra e Karrierës, kuptohet se sa mirë janë të përgatitur studentët për tregun e punës. Raportet periodike të hartuara nga njësia përgjegjëse për programin e studimit profesional 2 vjeçar "Ndihmës Dentist" në</p>




	<p>UAMD, ofrojnë një pasqyrë të detajuar të cilësisë së studentëve në hyrje dhe dalje, si dhe shkallën e suksesit të tyre në punësim. Këto raporte janë burim i rëndësishëm për të kuptuar ku mund të përmirësohet programi dhe për të ndërmarrë hapa për këtë. Bazuar në analizat dhe raportet, identifikohen fushat për të përmirësuar cilësinë. Masa të tilla përfshijnë rishikimin e procesit të aplikimit, ofrimin e trajnimeve shtesë për të përgatitur studentët për tregun e punës, dhe forcimin e lidhjeve me punëdhënësit për të siguruar mundësi të punësimit më të mira për studentët. <i>Dokumentat e ofruara, Raporte të NjsBC.</i></p> <p><i>Takimi me sekretarinë</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni i UAMD, në strukturën e tij disponon zyrën e kryesekretarisë mësimore, ku ruhen, mbledhen të dhëna të cilat përpunohen në statistika vjetore me numrin e studentëve, kalueshmërinë, largimet dhe të diplomuarit për çdo program studimi. Raportet analitike periodike dhe vjetore përgatiten nga Njësia përgjegjëse për programin e studimit mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e e punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Këto raporte do të shërbenin edhe si udhërefyese për akreditimet e programeve apo ato institucionale në të ardhmen.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>UAMD duke u bazuar në LAL, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garanton të drejtën e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të UAMD. Studentët kanë përfaqësinë e tyre edhe në Komisionin e Etikës, Senatit akademik. Ata kanë Këshillat studentore ku organizohen dhe përzgjedhin anëtarët përfaqësues të tyre. Studentët kanë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre të cilat respektohen dhe zbatohen sipas rregulloreve përkatëse të universitetit. <i>Takimi me studentët</i></p> <p><u>Evidenca Nr.27 Të dhëna tabelore për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në S.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete,</p>	<p>Studentët votojnë për të përzgjedhur përfaqësuesit e tyre në Organet Vendimmarrëse. Ky proces kryhet në fshehtësi dhe në mënyrë transparente dalin emrat e kandidatëve fitues. Rezultatet publikohen dhe të gjithë studentët njihen me to. Këta anëtarë nëpërmjet kontakteve të tyre bëjnë lidhjen ndërmjet mentorëve të grupeve, sekretarisë, pedagogëve etj. Zëri i studentëve dëgjohe dhe propozimet e tyre</p>

frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	merren parasysh deri në organin më të lartë në Senat. UAMD garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim në mënyrë reale dhe konkrete. <i>Takimi me studentët</i> Evidenca Nr.89 Komisionet me përbërje të studentëve.pdf			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Në UAMD, studentët të mbështetur nga Njësia mbështetëse dhe përgjegjëse përfshihen në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Ata japin kontributin e tyre duke dhënë mendime dhe sygjerime në mbledhjet e përbashkëta të departamentit, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj për përmirësimin e mësimdhënies, aktivitetet e Universitetit, kërkimin shkencor. Anketimet e studentëve kanë një vlerë të veçantë sepse reflektojnë punën e kryer nga stafi akademik në shërbim të studentëve duke lejuar përmirësimin e vazhdueshëm dhe rritjen e institucionit. <i>Takimi me studentët</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Të gjithë studentët në barazi të plotë kanë të drejtën që në mënyrë transparente sipas rregullores të FSP, të paraqesin kërkesat për rishikim dhe ankimim të rezultateve të provimit. Për çdo problem dhe shqetësim ata janë të mirëpritur të diskutojnë dhe të marrin përgjigje duke filluar nga mentori e deri në organin e Senatit Akademik të UAMD sipas një shkalle hierarkie. <i>Takimi me studentët</i>			
Konkluzione	<i>UAMD duke u bazuar në LAL, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garanton të drejtën e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të UAMD. Studentët të mbështetur nga Njësia mbështetëse dhe përgjegjëse përfshihen në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Të gjithë studentët në barazi të plotë kanë të drejtën që në mënyrë transparente sipas rregullores të FSP, të paraqesin kërkesat për rishikim dhe ankimim të rezultateve të provimit. Për çdo problem dhe shqetësim ata janë të mirëpritur të diskutojnë dhe të marrin përgjigje duke filluar nga mentori e deri në organin e Senatit Akademik të UAMD sipas një shkalle hierarkike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6



Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret

Vlerësimi




<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Studentët marrin informacion të plotë dhe të saktë në vendin e duhur sepse mundësitë për të marrë informacion janë të shumta. Ata mund të aksesojnë faqen e Universitetit, platformën digjitale të integruar, të lexojnë standat ku afishimet përditësohen sipas aktiviteteve, në rrjetet sociale, takimit direkt me mentorët, drejtuesit, sekretarinë, Zyrën e Karrierës, koordinatorët e praktikave etj. Përfaqësuesit e studentëve kanë krijuar bashkëpunim me pedagogët e Njësive bazë dhe mentorët e tyre duke lehtësuar komunikimin. Mjetet dhe format digjitale krijojnë një mundësi tjetër komunikimi. Për dokumente zyrtare komunikimi bëhet nëpërmjet Kryesekretarisë.</p> <p><i>Dokumentat e ofruara për Rregulloret, dosje e ZKAK. Takimi me ZKAK, studentët</i></p> <p><u>Evidenca Nr.100 Njoftime ne rrjetet sociale te FSP.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.87 Mentorimi i studenteve dhe oraret e konsultimeve.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Pedagogët mentorë janë një urë lidhëse midis studentëve dhe pedagogëve sipas grupeve të tyre në ngarkim. Ata ndihmojnë studentët për t'u informuar, këshillojnë, dhe ndjekin përparimin e tyre në procesin mësimor dhe programin e studimit profesional 2 vjeçar "Ndhmës Dentist" në UAMD. Ndjekja dhe shoqërimi nga koordinatori i praktikave ndihmon studentët në lidhjen e teorisë me praktikën dhe realizimin me sukses të procesit mësimor.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p> <p><u>Evidenca Nr.87 Mentorimi i studenteve dhe oraret e konsultimeve.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Njësia kryesore për këshillim, informim, orientim për studentët është ZKAK, e cila vihet në dispozicion të studentëve për ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime, intership, si për studentët që vazhdojnë studimet në programin e studimit profesional 2 vjeçar "Ndhmës Dentist" në UAMD, ashtu edhe për të diplomuarit nëpërmjet lidhjeve dhe bashkëpunimeve efektive.</p> <p><i>Takimi me ZKAK, studentët</i></p> <p><u>Evidenca Nr.86 Model Pycësori për Studentet e Diplomuar.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.84 Udhezues nga zyra Karrieres - aplikim pune.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.100 Njoftime ne rrjetet sociale te FSP.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Studentët në prag diplomimi dhe studentët Alumni informohen dhe mbështeten nga ZKAK, përmes disa aktiviteteve, që kanë si qëllim, njohjen dhe përafrimin e studentëve me tregun e punës, përgatitjen për tu bërë pjesë e profesionistëve duke punuar me ta në klinika dentare. Studentët mësohen të përgatisin dokumentacionin e tyre, një CV, një kërkesë punë, të dinë se si të prezantohen në një intervistë pune, të tregojnë aftësitë e tyre profesionale të fituara përgjatë studimeve si "Ndhmës Dentist" në UAMD. Të dhënat mbi numrin e studentëve aktualë, të diplomuar kontaktet e tyre, numrin e të punësuarve ruhen në një database me informacionin e tyre personal, kontaktet dhe vendin e</p>

	<p>punësimit. ZKAK orienton dhe informon personat e interesuar për UAMD, programet e studimit, si dhe për të vijuar studimet në këtë IAL.</p> <p><i>Takimi me ZKAK, studentët</i></p> <p><u>Evidenca Nr.12 Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Nr.84 Udhezues nga zyra Karrieres - aplikim pune.pdf</u></p>			
Konkluzione	<p><i>Studentët-marrin informacion të plotë dhe të saktë në vendin e duhur sepse mundësitë për të marrë informacion janë të shumta. Ata mund të aksesojnë faqen e Universitetit, platformën digjitale të integruar, të lexojnë stendat ku afshimet përditësohen sipas aktiviteteve, në rrjetet sociale etj, takimit direkt me mentorët, drejtuesit, sekretarinë, Zyrën e Karrierës, koordinatorët e praktikave etj. Njësia kryesore për këshillim, informim, orientim për studentët është ZKAK, e cila vihet në dispozicion të studentëve për ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime, intership, si për studentët që vazhdojnë studimet në programin e studimit profesional 2 vjeçar "Ndihmës Dentist" në UAMD, ashtu edhe për të diplomuarit nëpërmjet lidhjeve dhe bashkëpunimeve efektive.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Ndihmës Dentist” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit 2 vjeçar në “Ndihmës Dentist” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universteti “Aleksandër Moisiu” Durrës funksionon bazuar LAL në fuqi si dhe rregullatorëve të brendshme të tij në përputhje të plotë me strategjinë kombëtare të zhvillimit.
2. Ambjentet e UAMD plotësojnë kushtet optimale për realizimin e programit mësimor të pajisura me hapësirat, pajisjet dhe materialet e duhura bashkëkohore në funksion të përgatitjes së studentëve në auditore dhe sallat e laboratorëve.
3. Bibliotekat e UAMD janë në funksion të studentëve dhe stafit dhe posedojnë material fizik dhe digjital të viteve të fundit për fushën e dentistrisë dhe asistentit dentar në gjuhë shqipe dhe të huaj.
4. Si një program me karakter profesional ai garanton përgatitjen e studentëve duke ndërthurur teorinë me praktikën falë edhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme shëndetësore kryesisht klinika dentare.
5. Numri i vogël i studentëve ndikon në mundësitë më të mira për përfitimin e dijeve, punës me grupe të vogla me nivel e cilësi më të lartë të rezultateve mësimore.
6. Studentët nëpërmjet këtij program studimi kanë plotësuar qëllimin dhe objektivat e tyre përshtatur nevojave të tregut si brenda vendit dhe jashtë tij.

Pika të dobëta:

1. Botimi i teksteve mësimore bazë në gjuhën shqipe për programin e studimit profesional në “Ndihmës Dentist”. **(Standardi II.4, kriteri 5)**
2. Paisja e sallave të praktikave laboratorike profesionale me instrumentat dhe paisjet dentare sipas disiplinave stomatologjike përkatëse. **(Standardi IV.2 kriteri 2,3)**

Rekomandime:

1. Përveç cikleve të leksioneve të përgatitura nga pedagogët e secilit modul do të ishte e këshillueshme të parashikohej botimi i teksteve mësimore bazë, në gjuhën shqipe të miratuara nga UAMD për programin e studimit “Ndihmës Dentist”.
2. Projektet pedagogjike dhe studentore të organizuara brenda dhe jashtë IAL të jenë në fokus të aktiviteteve akademike të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin personal, intelektual dhe profesional të studentëve “Ndihmës Dentar” si dhe pedagogëve të tyre.
3. Fushatat e promovimit të organizohen në takimet e përcaktuara me një plan të detajuar për të afruar më tepër studentë në programin e studimit në “Ndihmës Dentist”.
4. UAMD duhet të krijojë më tepër mundësi për aktivitete studentore, sportive, argëtuese, krijuese, etj.

Evaluation's conclusions for the professional study program "Dental Assistant" offered by the Higher Education Institution "Aleksander Moisiu" University of Durrës.

Strengths and affirmations:

1. The study program in "Dental Assistant" offered by the Higher Education Institution "Aleksander Moisiu" University of Durrës operates based on the Law on Higher Education in force as well as its internal regulations in full compliance with the national development strategy.
2. Through the statute and internal regulations of UAMD, the entire organization and functioning for each study program has been realized by effectively managing every activity described in them.
3. UAMD libraries were in the function of students and staff and possessed physical and digital material of recent years for the field of dentistry and dental assistant in Albanian and foreign languages.
4. As a professional program, it guaranteed the preparation of students by combining theory with practice thanks to cooperation agreements with various health institutions mainly dental clinics.
5. The small number of students influenced the best opportunities for knowledge gain, working with small groups with higher level and quality of learning outcomes.
6. Students through this study program had fulfilled their purpose and objectives adapted to the needs of the market both within the country and abroad.

Weaknesses:

1. Publication of basic textbooks in the Albanian language for the professional study program in "Dental Assistant".
2. Equipping professional practice laboratories with dental instruments and equipment according to the relevant dental disciplines.

Recommendations:

1. In addition to the lecture cycles prepared by the lecturers of each module, it would be advisable to foresee the publication of the basic texts, in the Albanian language, approved by UAMD for the study program in "Dental Assistant".
2. Pedagogical and student projects organized inside and outside HEI should be at the center of academic activities which will help in the personal, intellectual and professional development of "Dental Assistant" students as well as their teachers.
3. In the meetings determined with a detailed plan, promotional campaigns should be organized to bring more students to the study program in "Dental Assistant".
4. UAMD should create more opportunities for student activities, sports, entertainment, creativity, etc.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Udhëzues *Prof.*